	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
 TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
 OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRŽIŠTA KOSTT d.d

Nr. 571 Dt. 15 03 2021
 PRISHTINË-A

KOSTT

Raport Vjetor 2020

(01.01.2020-31.12.2020)


Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e 120/21 të datës 12 mars 2021 miratoi Raportin Vjetor për vitin 2020

Vendimi 210312-II/3

Bordi i Drejtorëve në bazë të Nenit 31.3 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Nenit të 14.2.2.11.2 të Statutit të Shoqërisë Aksionare KOSTT, njëzëri dhe me vërejtjet e dhëna miratoi Raportin Vjetor për vitin 2020.


	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Nebih Haziri - Zytar Kryesor për Financa dhe Trezor	Mustafë Hasani - Kryeshef Ekzekutiv	Bordi i Drejtoreve Jeton Mehmeti Kryesues i BD
Nënshkrimi			
Data	Shkurt, 2021	Shkurt, 2021	Mars, 2021




	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Përmbajtja:

Lista e shkurtesave	6
1. Hyrje	9
1.1. Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT	10
1.2. Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT sh. a	11
1.3. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 2020.....	13
1.4. Makro Struktura organizative e KOSTT	14
2. Raporti i Bordit të Drejtorëve.....	15
2.1. Përbërja e Bordit dhe aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit	15
2.2. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv.....	16
3. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv.....	18
3.1. Arritjet kryesore	18
3.2. Ngjarjet kryesore të vitit.....	25
3.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances	35
3.3.1. Bilanci i planifikuar dhe e realizuar për Janar-Dhjetor 2020	35
3.4. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit.....	38
4. Operimi i Transmisionit	40
4.1. Rrjeti transmetues aktual i Kosovës	40
4.2. Indikatorët Kyç të Performancës për operimin e transmetimit	41
5. Operimi i tregut	44
5.1. Madhësia e Tregut.....	44
5.2. Hapja e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe implementimi i Mekanizmit Balancues.....	45
5.3. Fondi BRE (Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë elektrike)	48
6. Pasqyra e performances financiare dhe Rezultatet	50
6.1. Pasqyra e Pozicionit Financiar 31.12.2020	50
6.2. Pasqyra e të ardhurave Euro (000).....	51
6.3. Pasqyra e ndryshimeve në kapital 31.12.2020.....	52
6.4. Pasqyra e Rrjedhës së Parasë 2020	53
6.5. Analiza e IKP-ve financiare	54
6.6. Progresi me planin e Biznesit	55
Moto e KOSTT.....	56
7. Realizimi I Projekteve Kryesore Kapitale Gjatë Vitit 2020.....	63


	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

7.2. Perspektiva për vitin e ardhshëm.....	69
7.2.1. Në kuadër të zhvillimeve kryesore nga aspekti i operimit të tregut, do të veçohen:	71
7.2.2. Menaxhimi i procesit të Ndërrimit të Furnizuesit	71
7.3. Sfidat e KOSTT	72
7.4. Aktivitetet tjera	74
8. Rreziqet	76
9. Aneks	77
9.1. Sponsorimet dhe donacionet	77
10. Raporti i Auditorit të Brendshëm	77
11. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike	82
11.1. Politika e personelit në KOSTT	82
11.1.1. Struktura kualifikuese.....	83
11.2. Numri I punetoreve	84
12. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore	89
13. Kontratat/transaksionet e konsiderueshme gjatë vitit 2020 nga burimet e KOSTT	122
14. Sugjerime dhe propozime për rritjen e performancës.....	123

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	


Lista e Tabelave:

Tabelë. 2-1. Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve	17
Tabelë. 3-1. Aktivitetet për harmonizimin dhe krijimin e kornizës rregullative funksionale	23
Tabelë. 3-2. Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike me të dhëna të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2020.....	36
Tabelë. 3-3.....	38
Tabelë. 4-1. Indikatorët Kyç të Performancës për operimin e transmetimit	43
Tabelë. 5-1. Prodhimi nga BRE pjesëmarrës në Skemën Mbështetëse	49
Tabelë. 6-1. Pasqyra e Pozicionit Financiar	50
Tabelë. 6-2. Pasqyra e të Ardhurave	51
Tabelë. 6-3. Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	52
Tabelë. 6-4. Paqyra e Rrjedhës së Parasë.....	53
Tabelë. 6-5. Analiza e IKP-ve financiare	54
Tabelë. 7-1. Realizimi i buxhetit të projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2020.....	67
Tabelë. 10-1. Departamentet e audituara dhe numri i rekomandimeve.....	80
Tabelë. 10-2. Gjendja e implementimit të rekomandimeve në fund të vitit 2020	82
Tabelë. 11-1. Numri I punetoreve sipas Departamenteve.....	85
Tabelë. 13-1. Kontratat/Transaksionet gjatë vitit 2020 nga burimet e KOSTT	123

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Lista e Figurave:

Fig. 1-1. Makro Struktura organizative.....	14
Fig. 3-1. Disponueshmëria totale e linjave gjatë vitit 2020.....	19
Fig. 3-2. Disponueshmëria totale e linjave gjatë vitit 2020.....	20
Fig. 3-3. Disponueshmëria e nënstacioneve gjatë vitit 2020.....	20
Fig. 3-4. Bilanci i planifikuar dhe i realizuar 2020.....	36
Fig. 3-5. Bilanci i realizuar elektroenergjetik Janar-Dhjetor 2020.....	37
Fig. 5-1. <i>Të dhënat themelore energjetike</i>	44
Fig. 5-2. Tregu i rregulluar dhe pa rregulluar Hapja e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe implementimi i Mekanizmit Balancues.....	44
Fig. 5-3. Pjesëmarrja në tregun e energjisë elektrike në Kosovë.....	46
Fig. 5-4. Pjesëmarrja e blerjes së humbjeve nga KEK dhe Ankandi.....	47
Fig. 5-5. Prokurimi i energjisë balancuese 2020.....	48
Fig. 5-6. Pjesëmarrja e blerjeve të energjisë nga ana e KOSTT për vitin 2020.....	48
Fig. 10-1. Planifikimi dhe realizimi i auditimeve gjatë vitit 2020.....	79
Fig. 10-2. Treguesit e auditimeve / rekomandimeve, për periudhën 2017 -2020.....	80
Fig. 10-3. Treguesit e rekomandimeve për vitin 2020.....	81
Fig. 11-1. Lëvizja e punëtorëve gjatë vitit 2020.....	84
Fig. 11-2 Punëtorët sipas statusit të punësimit.....	85
Fig. 11-3. Punëtorët e pranuar dhe të pensionuar.....	85
Fig. 11-4. Numri I punetoreve sipas gjinise ne njesi organizative.....	86
Fig. 11-5. Grupimi i punëtorëve sipas kualifikimit.....	86
Fig. 11-6. Grupimi i punëtorëve sipas profesionit me diplomë akademike.....	87
Fig. 11-7. Punëtorët sipas grup moshave.....	87
Fig. 11-8. Punëtorët sipas lokacionit.....	88

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 6 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Lista e shkurtesave

AATC - (Average Available Transfer Capacity) - Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar (Import/Eksport)

AC-DC – Shpenzimet vetanake

ACE – Area Control Error (Gabimi zones rregulluese)

AIT – (Average interruption time) - koha mesatare e rënieve

AK LFC - Blloku Kosove- Shqiperi per rregullim te frekuences

aFRR- Automatic Frequency restoration Reserves (Rregullimi automatik I frekuences)

ATC – (Available Transfer Capacity) – Kapaciteti i disponueshëm

BCU- (Bay Controll Unit)- njësia kontrolluese

BERZH – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

BRE- Burimet e Ripërtërishme të Energjisë

CAO – (Capacity Allocation Office) – Zyra e Alkoimit të Kapaciteteve

CGES- (Crnogorski Elektro Sistem) – OST i Malit të Zi

CGM\OPDE (common grid model/ operational planning data environment) - Modeli i rrjetit të bashkuar/ infrastruktura për grumbullimin e të dhënave për planifikimin operativ

CM – (Congestion Management)- Menaxhimi i kongjestioneve

BERZH – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

EAS (energy awarness system) - Sistemi për vetëdijesimin me situatën energjetike

EJL – Evropa Juglindore

EMI – (Electricity Market Iniciative)– Nisma për Tregun e Energjisë Elektrike

EMS- (Elektro Mreza Srbije) - Rrjeti Elektrik i Serbisë

ENS- (Energy not supplied)-Energjia e pa furnizuar

ENTSO E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike

HC - Hidrocentral


IKP – Indikatorët Kyç të Performancës

IPA- Instrumentet para anëtarësimit në Bashkimin Evropian

ITC – Inter TSO Compensation (Kompensimi mes Operatorëve të Sistemit të Transmetimit)

KA – Konflikt Administrativ

KAEF – (Kosovar American Edication Fund) – Fondi Kosovar Amerikan për Arsim

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KESCO - (Kosovo Electricity Supply Company)- Kompania e Kosovës për Furnizim me Energji Elektrike

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

LEE – Ligji për Energjinë Elektrike

LFC Zonë – Load Frequency Control

LP – Largpërçuesi

MATC - Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal (Import/Eksport)

MBE – Marrëveshja për Blerjen e Energjisë

mFRR - Rezerva Manuale për Restaurimin e Frekuencës

MEPSO (Makedonski Elektroprenosen Sistem Operator) – Operatori i sistemit dhe transmetimit të Maqedonisë

MSA – Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

MEA – Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

NS - Nënstacioni

NP – Ndërmarrjet publike

NJPMNP – Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

OPC (Outage Planning Coordination) - Planifikimi i Çkyçjeve të Koordinuara

OPGW – fibri optik

OS – Operatori i Sistemit

OST – Operator i Sistemit të Transmetimit

OT – Operatori i Transmetimit

PZhT – Plani Zhvillimor i Transmetimit

PShK – Përgjegjësia Shoqërore Korporative

RSCI – (Regional Security Coordination Initiative) – Iniciativa për koordinim të sigurisë rajonale)


RGCE - Grupi Regjional i Evropës Kontinentale

SAFA- Synchronous Area Framework Agreement (Marreveshja kornize e zones Sinkrone)

SCADA /EMS-System Control and Data Acquisition/Energy Management System (Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i menaxhimit të energjisë)

SKE – Sekretariati i Komitetit të Energjisë

SCC (Security critical coordination) - Kordinimi i sigurisë kritike

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

SEE – Sistemi Elektro Energjetik

SMTA – (Short- & Medium-Term Generation Adequacy) - Adekuacia afatshkurtër dhe afatmesme e gjenerimit

SSH - Stacioni Shperndares

SOGL- System Operation Guidline (Udhezuesi I operimit te sistemit)

TC A – Termocentrali Kosova A

TC B – Termocentrali Kosova B

TE- (Transmitted energy)- Energjia e transmetuar

TI K– Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi


TMR – Transformatori matës i rrymës

TL – Tensioni i lartë

TTC – (Total Transfer Capacity) – kapaciteti total i bartjes

USAID - (Unated States Agenci for International Development) – Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar)

ZRrE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë


	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 9 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

1. Hyrje

Raporti Vjetor për vitin 2020 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Sipas këtij Ligji, brenda 45 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport vjetor i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Raporti është punuar sipas formës së aprovuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike ndërsa përmbajtja e tij është e bazuar në “Udhëzuesin për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjes Publike”.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2020 si dhe të aktiviteteve krahasuar me Planin e Biznesit, planin vjetor dhe shkallën e realizimit, respektivisht, implementimin e Planit të Biznesit.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

1.1. Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT

Viti që lamë pas, përkundër vështirësive të shkaktuara nga pandemia Covid 19, ishte një vit i shkëlqyeshëm për sa i përket arritjes së synimeve të KOSTT.

Performanca pozitive e KOSTT, vazhdoi edhe gjatë vitit 2020, e karakterizuar me zhvillime të shumta.

Janë realizuar projekte të rëndësishme kombëtare, të cilat janë arritur falë angazhimit dhe përkushtimit shumëvjeçar të KOSTT, të cilat kanë bërë që KOSTT-i të rangohet në hartat energjetike të Evropë si institucion shumë i besueshëm dhe kredibil. Këto suksese përbëjnë arritje historike jo vetëm për Kompaninë, por edhe për gjithë Sektorin e Energjisë në Republikën e Kosovës. Në mesin e këtyre sukseseve janë: Pavarësimi Energjetik i Republikës së Kosovës, Operimi i Pavarur i KOSTT si Zonë Rregulluese Brenda Bllokut rregullues Kosovë-Shqipëri, Funkcionalizimi i Linjës Interkonektive 400 kV, që paraqet një vepër strategjike në rritjen e kapaciteteve dhe sigurisë elektro-energjetike. Një moment të veçantë, padyshim, paraqet edhe nënshkrimi i Marrëveshjes për Themelimin e Tregut të Përbashkët të Energjisë Elektrike Kosovë-Shqipëri. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX, dhe kjo bursë do të rrisë sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe shfrytëzimin më efikas të kapaciteteve ndërkufitare ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.


Në funksion të përmbushjes së detyrave të veta, Bordi i Drejtorëve të KOSTT, në vazhdimësi ka monitoruar zhvillimet në kompani duke i krahasuar ato me objektivat e përcaktuara me Planin e Biznesit dhe dokumentet tjera.

Ne si Bordi i Drejtorëve jemi të përkushtuar për zhvillimin e mëtejshëm të KOSTT, gjithnjë duke pasur parasysh se zhvillimit të sistemit i paraprind zhvillimi dhe motivimi i punonjësve të saj. Bordi i Drejtorëve mbetet i zotuar dhe fuqishëm beson se sukseset e KOSTT nuk do të mungojnë as në vitin 2021 dhe shpreh mirënjohjen për të gjithë punonjësit dhe menaxhmentin e KOSTT sh.a.

Sinqerisht i juaji,

Jeton Mehmeti

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

1.2. Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT sh. a

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Përkundër sfidave me të cilat u ballafaqua i gjithë globi në vitin 2020 në përballje me pandeminë e Covid 19, siguria e furnizimit me energji elektrike në vazhdimësi përbën një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm në jetën e çdo qytetari dhe në ekonominë e secilit vend të globit. Rrjedhimisht, edhe detyra kryesore e KOSTT, për të ofruar shërbime kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmetimit ishte e pandalshme. Ndër prioritetet kyçe në këtë periudhë ishin mbrojtja e shëndet të punonjësve në njërën anë dhe sigurimi i funksionimit të sigurt të rrjetit të transmetimit si hallkë kyçe për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, në anën tjetër.

Me investimet kapitale që janë realizuar në zhvillimin e rrjetit të transmetimit, në vlerë të përgjithshme prej mbi € 237 milion që nga themelimi i KOSTT, me operimin e sistemit me metodat optimale si dhe mirëmbajtjen preventive të rrjetit, është ndikuar dukshëm në rritjen e performancës së Sistemit të Transmetimit të Kosovës ndër vite. Për periudhën 14 vjeçare kapacitetet bartëse janë rritur për 101 % dhe në vitin 2020 përfundimisht u arrit që të plotësohet kriteri teknik i sigurisë së furnizimit N-1 në sistemin e transmetimit duke siguruar kështu shkallë të lartë të disponueshmërisë dhe besueshmërisë së transmetimit të energjisë elektrike.

Viti 2020 ka shënuar rritje të rrjedhave të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit për 7.9% në krahasim me vitin 2019 dhe nga Qendra Nacionale Dispeçerike e Kosovës janë menaxhuar gjithsej 8920 GWh energji elektrike gjatë këtij viti me pikun prej 1249 MW arritur me datë 21 dhjetor 2020. Niveli i humbjeve teknike në transmision vazhdon të jetë më i ulët në rajon apo për 1.04% nën vlerën e planifikuar me Bilancin vjetor të energjisë elektrike aprovuar nga ZRrE. KOSTT konsiderohet një ndër OST-të më të avancuara në regjion dhe më gjerë për nivelin e ulët të humbjeve teknike në rrjet.


Arritjet e KOSTT gjatë vitit 2020 padyshim kanë bërë historinë në sektorin e energjisë në Kosovë duke hapur kështu kapitull të ri në funksionimin e sistemit elektroenergjetik si dhe në zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në vend.

Pas angazhimeve të vazhdueshme, me datë 14 dhjetor 2020 përfundimisht hyri në fuqi Marrëveshja e Kycjes KOSTT/ENTSO-E e cila ishte edhe çelësi i progresit shumë-dimensional për KOSTT:

Përfundimisht KOSTT u shkëput nga Blloku SMM dhe filloi operimin e pavarur si Zonë Rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë (Blloku AK) duke krijuar kështu kushte të përshtatshme për shfrytëzimin optimal të burimeve gjeneruese brenda Bllokut AK.

Për herë të parë në historinë e sektorit të energjisë të Republikës së Kosovës filloi alokimi i kapaciteteve interkonektive (ndërshtetërore) nën mbikëqyrje nga KOSTT dhe inkasimi i të hyrave nga shitja e tyre

U funksionalizua nga aspekti komercial linja interkonektive e tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri, investim i përbashkët me Bankën Gjermane për Zhvillim-KfW ndërtimi i së cilës ka përfunduar që në vitin 2016.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

U themelua Bursa Shqiptare e Energjisë-ALPEX që shënon një standard të ri të operimit në sektorin e energjisë. Një institucion i rëndësishëm për zhvillimin e tregut konkurrues të energjisë elektrike për të dyja vendet Kosovë dhe Shqipëri, përmes së cilit do të sigurohet transparencë, konkurrencë në treg dhe shfrytëzim efikas i kapaciteteve interkonektive, në përputhje me politikat shtetërore të të dyja vendeve, legjislacionin evropian dhe obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.

Në anën tjetër, edhe këtë vit është dëshmuar stabiliteti financiar i kompanisë, duke i përmbushur në kohë të gjitha obligimet karshi kontraktorëve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare për kreditë zhvillimore. KOSTT gjithashtu vazhdon që të mbetet shembull në menaxhimin financiar në sektorin publik duke arritur në vazhdimësi Raport të Auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare, pa asnjë kualifikim.

Me punën e vazhdueshme profesionale, ne kemi arritur që të jemi një nga Operatorët e Sistemit të Transmetimit më të avancuara në rajon dhe shpesh herë e cilësuar nga palë të interesit si një nga kompanitë publike më të suksesshme në vend dhe më gjerë. Tutje, si rezultat i menaxhimit dhe operimit të kujdesëshëm të sistemit të transmetimit, pas monitorimit të rregullt në baza ditore dhe javore, performansa e KOSTT në balancimin e sistemit të Kosovës u vlerësua lartë nga ana e Swissgrid (Qendra koordinuese e zonës sinkrone të Evropës Kontinentale, në kuadër të ENTSO-E).

Sukseset e KOSTT në përmbushjen e objektivave strategjike të Planit të Biznesit dhe krijimit të vlerës për aksionarin, janë rezultat i përkushtimit dhe angazhimit të të gjithë punonjësve të kompanisë dhe ekipit menaxherial me mbështetje konstruktive dhe qasje profesionale nga ana e Bordit të Drejtorëve të KOSTT.

Na mbesin përpara mjaft sfida të ndjeshme të cilat duhen adresuar gjatë vitit 2021 siç janë: zgjidhja e bllokimit të kapaciteteve interkonektive të Kosovës me Serbinë, situatë e krijuar si pasojë e mungesës së bashkëpunimit nga kompania homologe, si dhe sfidë tjetër mbetet pjesa veriore e Kosovës.


Na mbetet shumë punë për t'u bërë në vitin 2021 dhe me entuziazëm mbetem i përkushtuar dhe këmbëngulës që së bashku me kapitalin e vlefshëm njerëzor që posedon KOSTT, dhe me mbështetjen e Bordit të Drejtorëve, të ecim përpara agjendën e avancimit të tregut të energjisë elektrike të Kosovës dhe integritit të mëtutjeshëm në tregun rajonal dhe në atë panevropian; përparimit të agjendës për anëtarësimin e KOSTT në rrjetin OST-ve evropiane (ENTSO-E) si dhe implementimit në vazhdimësi të obligimeve karshi legjislacionit vendor dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Derisa, synimi ynë i vazhdueshëm është kontributi nga këndi ynë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, industrial dhe shoqëror të vendit tonë.

Mbesim të zotuar në bashkëpunimin e frytshëm me institucionet tona shtetërore si dhe të gjitha palët e interesit vendore dhe ndërkombëtare të cilat ka qenë shpesh herë element shtytës për ne në rrugëtimin e suksesshëm të KOSTT ndër vite.

Në Raportin Vjetor i cili është prezantuar në vijim, mund të gjeni një pasqyrë më të detajuar të aktiviteteve, zhvillimeve dhe performansës së KOSTT gjatë vitit 2020. Sinqerisht,

Mustafë Hasani

Kryeshef Ekzekutiv

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

1.3. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 2020

Më 25 prill 2018, Bordi i Drejtoreve të KOSTT-it në mbledhjen nr.103/18, ka aprovuar Riorganizimin e brendshëm të KOSTT, përkatësisht makro skemën organizative. .

Ndryshime janë reflektuar në shumicën e departamenteve, zyrave dhe sektorëve në departamente. Ndryshimet në harmoni me vendimet e Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv janë implementuar nga 01.05.2018 dhe shihen në Makro Skemën Organizative të KOSTT.

Sipas kësaj strukture, menaxhmenti më i lartë i KOSTT-it përbëhet nga pozitat vijuese: Kryeshefi Ekzekutiv (KE), Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv; Sekretari i Kompanisë; Zyrtaari Kryesor Financiar dhe i Thesarit, Auditori i Brendshëm dhe Drejtorët e departamenteve vijuese:

- Operatori i Sistemit;
- Operatori i Transmetimit;
- Operatori i Tregut;
- Zhvillimi i Rrjetit dhe Projekteve;
- Çështjet Rregullative dhe Tarifa;
- Financat dhe Thesari;
- Burimet Njerëzore;
- Shërbimet Përkrahëse
- Prokurimi;

Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv, që mbulon Zyrën për Zhvillimin dhe Planifikimin Afatgjatë, Zyrën për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, Zyrën Ligjore dhe Menaxheri për Cilësi dhe Politika.

Në kuadër të riorganizimit të fundit është shtuar edhe një vlerë e re në makro –strukturë si KOSTT Consulting. Për funksionalizimin e KOSTT Consulting janë zhvilluar aktivitetet e para në lidhje me definimin e kornizës përmbajtjesore për të, në bashkëpunim me Repower (USAID).

Ekzistojnë një sërë çështjesh që do të kenë ndikim në organizimin e KOSTT-it, si:

- Zhvillimi i sistemit të Transmetimit nga këndvështrimi i kapaciteteve të rrjetit dhe kontrollimit të tij;
- Nevoja për të arritur nivel më të lartë efikasiteti brenda kompanisë;
- Nevoja për zhvillim të stafit dhe për zhvillim të infrastrukturës si rrjedhojë e integritimeve në institucionet ndërkombëtare Evropiane dhe rajonale, si dhe ndryshimeve dhe zhvillimeve në tregun e energjisë elektrike.

- Hyrja e KOSTT-it në tregun e telekomunikimeve të Kosovës dhe në tregun e telekomunikimeve dhe integrimin me vendet e rajonit, duke filluar iniciativën me OST-të fqinjë (nga Banka Botërore ka filluar interesimi për të mbështet fillimin e një projekti për ndarjen e infrastrukturës ndërkufitare të telekomunikacionit respektivisht të fibrave optik), me ofrim të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

1.4. Makro Struktura organizative e KOSTT





Fig. 1-1. Makro Struktura organizative

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 15 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

2. Raporti i Bordit të Drejtorëve

2.1. Përbërja e Bordit dhe aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit

KOSTT nuk ka pasur Bord të Drejtorëve të emëruar që nga 2 shtatori 2018 deri me 10 korrik 2020. KOSTT për gati dy vite ka funksionuar pa Bord të Drejtorëve, gjë që ka shkaktuar pengesa në proceset zhvillimore të KOSTT, e në veçanti inicimit dhe implementimit të projekteve kapitale për zhvillimin e infrastrukturës së transmisionit.

Në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Nenin 14 të Ligjin për energjinë elektrike (Ligji Nr. 05/L – 085) me datë 10 korrik 2020 Kuvendi i Kosovës me vendimin Nr.07-V- 23 të datës 10 korrik 2020 ka emëruar tre anëtarë të Bordit të Drejtorëve:

- Jeton Mehmeti (Kryesues)
- Arben Dodaj, Anëtarë
- Nebih Zariqi, Anëtarë

Mbledhja konstitutive e përbërjes së re të Bordit të Drejtorëve është mbajtur me 21 korrik 2020.

Ndërsa me datë 29 tetor 2020 Kuvendi i Kosovës me vendimin Nr. 07-V-083 të datës 29.10.2020 ka emëruar edhe dy anëtare të reja të Bordit të Drejtorëve:


- Znj. Ajrina Gashi Hamdiu, Anëtare
- Znj. Xhyldane Kiçmari, Anëtare

Kryeshefi Ekzekutiv sipas detyrës zyrtare në pajtim me Ligjin për ndërmarrje publike është anëtarë i Bordit të Drejtorëve.

Gjatë vitit 2020 Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka mbajtur gjithsejtë 12 mbledhje, prej tyre 11 të rregullta si dhe 1 mbledhje të jashtëzakonshme. Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin për vitin 2020 nuk është mbajtur për arsye se në kohën e emërimit të Bordit të Drejtorëve kanë kaluar afatet ligjore për mbajtjen e mbledhjes.

Gjatë vitit 2020 Komisioni i Auditimit nuk ka qenë funksional për arsye se nuk janë emëruar anëtarët e Komisionit të Auditimit nga Kuvendi i Kosovës

Përveç çështjeve dhe vendimeve të paraqitura më lartë, Bordi i Drejtorëve në ushtrimin e të drejtave dhe detyrave sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike, në vazhdimësi kanë shqyrtuar performancën e KOSTT dhe kanë qenë mbështetës për menaxhmentin në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin e Biznesit.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 16 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

2.2. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv


Gjatë vitit 2020 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka qenë në përbërjen vijuese:

- z. Jeton Mehmeti, Kryesues i Bordit, me profesion ekonomist
- z. Arben Dodaj, Drejtor i Bordit, me profesion ekonomist
- z.Nebih Zariqi, Drejtor i Bordit, me profesion inxhinier
- znj. Ajrina Gashi - Hamdiu, Drejtore e Bordit, me profesion ekonomiste
- znj. Xhyldane Këçmari, Drejtore e Bordit me profesion ekonomiste

Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it përveq kompensimit të bazuar në vendimin e Kuvendit të Kosovës nr.05-V-389 të datës 01.12.2016, nuk ka pasë kompensime tjera si udhetime zyrtare, meditje apo bonuse tjera.

Në vazhdim janë paraqitur Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si vijon

Nr.	Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si vijon:
1	Raporti vjetor për vitin 2018
2	Raporti i auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2018
3	Raportin vjetor për vitin 2019
4	Raporti i auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2019
5	Plani i punës së Bordit të Drejtorëve për vitin 2020
6	Plani i biznesit të rishikuar për vitin 2020
7	Buxheti i rishikuar për vitin 2020
8	Raporti për tremujorin e dytë 2020 (TM2 2020)
9	Raportin për tremujorin e parë 2020 (TM1 2020)
10	Ndryshimi dhe plotësimi i Manualit Financiar të KOSTT
11	Autorizimi për negociimin e Marrëveshjes për themelimin dhe Statutit të ALPEX
12	Miratimi i marrëveshjes për themelimin dhe Statutit të ALPEX

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 17 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>

13	Politika mbi Barazinë Gjinore
14	Plani i Biznesit për vitin 2021
15	Buxheti për vitin 2021
16	Procedura për prokurimin shërbimeve ndihmëse
17	Emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të ALPEX
18	Zbatimi i urdhrit përmbarim i datës 28.12.2018 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për zbatimin e vendimit të Inspektoratit të Punës me numër 283/2017 të datës 21.11.2017 (kthimi në pozitën e Kryeshefit të z. Mustafë Hasani dhe shfuqizimi i vendimit për emërimin e z. Ilir Shala në pozitën e KE)
19	Raporti për tremujorin e tretë 2020 (TM3 2020)
20	Vendimi për ndarjen e shpërblimit në fund të vitit

Tabelë. 2-1. Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 18 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

3. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv

3.1. Arritjet kryesore

Përpjekjet e KOSTT-it qysh nga themelimi, ishin dhe do të jenë edhe në të ardhmen, të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike, të cilat janë në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin e KOSTT. Duke u bazuar në të gjitha këto, edhe gjatë vitit 2020, KOSTT ka vazhduar trendin e saj të performimit pozitiv, duke dëshmuar kështu se mbetet edhe më tutje një organizatë e qëndrueshme dhe efektive.

KOSTT ka zhvilluar infrastrukturën e operimit të sistemit dhe tregut, dhe tani është duke u përgatitur për sfidat e reja me të cilat do të përballlet në të ardhmen.

Në aspektin e aktiviteteve lidhur me Marrëveshjet ndër-OST, duhet të ceket realizimi i testimit dhe më pastaj vënies në operim të përhershëm të shkëmbimit të dhënave në kohë reale mes të KOSTT dhe OST në kontest të rregullimit sekondar.

Në kontest të infrastrukturës së re të grupeve matëse komerciale, në masë të madhe është siguruar besueshmëria në leximin e të dhënave orare të energjisë elektrike në distancë. Kjo gjendje leximi tani është duke realizuar përmes përdorimit të Fibrave Optikë në pronësi të KOSTT-it, që ka garantuar saktësinë e matjes së tyre në të gjitha pikat kufitare të rrjetit transmetues.

Gjatë vitit 2020 ka vazhduar të ketë kërkesa për krijimin e kushteve për implementimin e projekteve të reja dhe rehabilituese të rrjetit të transmetimit, si dhe për mirëmbajtje të planifikuar. Përkundër rrethanave të vështirësuar shkak të pandemisë Covid 19, janë organizuar punët për shqyrtimin e këtyre kërkesave. Disa prej këtyre kërkesave janë përcjellë me domosdonë e shqyçjeve të objekteve elektro energjetike, me ç' rast është zvogëluar siguria e furnizimit të pandërprerë. Në rastet e tilla janë bërë të gjitha përgatitjet gjatë fazës planifikuese dhe në kohë reale për operim të sistemit sa më të besueshëm, duke bërë koordinimin e gjithmbarshëm të këtyre shqyçjeve në aspektin brenda Kosovës si dhe në nivel rajonal. Përkundër këtyre rrethanave gjatë vitit 2020 është arritur që të mirëmbahet siguria e furnizimit dhe që kohëzgjatja e mos furnizimit të jetë e kontrollueshme.

Në mesin e detyrave të KOSTT dhe në përputhje me objektivat e saj strategjike, një nga detyrat kryesore mbetet edhe më tutje ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit. Sa i përket përmbushjes së kësaj detyre, KOSTT ka vazhduar trendin e performimit pozitiv, edhe gjatë vitit 2020.

KOSTT ka arritur që të garantoj një siguri të lartë të operimit dhe mund të thuhet se performanca e arritur është mjaftë e kënaqshme. Këtë e dëshmon numri i rënieve dhe intervenimeve, të cilat nga viti në vit kanë qenë në rënie dhe tani është arritur që të minimizohet numri i tyre, përkundër vjetërsisë dhe eksploatimit të tyre.

Njëkohësisht, që të sigurohet operim i sistemit sa më efikas, është duke u vazhduar me investimet në rehabilitimin e nënstacioneve sipas prioriteteve të caktuara në bazë të gjendjes funksionale të tyre.

Implementimi i suksesshëm i mirëmbajtjes dhe projekteve do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të KOSTT, në radhë të parë, në rritjen e kapacitetit të transmetimit, modernizimin e sistemit dhe mirëmbajtjen preventive, gjë që do të ndikojë në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit, që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 19 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Gjatë këtij viti është realizuar 96% e planit vjetor të mirëmbajtjes së linjave, 93% e mirëmbajtjes së Qarqeve Primare, 100% i Qarqeve Sekondare dhe 97% i Mbrojtjeve Rele, si dhe janë zhvilluar aktivitetet tjera të domosdoshme për sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm operativ dhe të sigurisë së sistemit elektroenergetik

Me qëllim të mirëmbajtjes sa më efektive, shfrytëzohet Rregullorja e Mirëmbajtjes e cila për bazë ka metodologjitë më të avancuara të qasjes në stabilimente duke marrë parasysh teknologjinë e përdorur si dhe afatet e duhura kohore për mirëmbajtje dhe shqyrtime të pajisjeve elektrike. Përmes kësaj synohet që oraret dhe aktivitetet e mirëmbajtjes në pajisje, të jenë sa më racionale duke u bazuar në gjendjen e pajisjeve. Në këtë mënyrë do të kursehet koha dhe kostoja e mirëmbajtjes.

Sipas planit për riorganizimin e punëve dhe stafit të miratuar nga Kryeshefi Ekzekutiv me datë 15.03.2020 janë pezulluar aktivitetet e planifikuara të mirëmbajtjes për gjysmën e muajit mars dhe muajin prill 2020 sipas vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës si pasojë e situatës së krijuar në vend me rastin e paraqitjes së virusit COVID-19 si pandemi botërore. Këto aktivitetet të gjysmës e muajit mars dhe muajit prill janë realizuar në muajin maj dhe qershor.

Poashtu, kontrollimi me termovizion dhe kontrollimi i përgjithshëm i nënstacioneve për arsye të pa mundësisë për qasjen në pjesën Veriore të Kosovës nuk është realizuar në NS Vallaçi, aktivitetet e paraparë për tremujorin e parë të vitit 2020;

Edhe kontrollimi i përgjithshëm i nënstacioneve dhe linjave për arsye të pa mundësisë për qasjen në pjesën Veriore të Kosovës nuk është realizuar në NS Vallaçi dhe dy linjat LP155/2 (L119), LP1800 (L138), aktivitetet e parapara për tremujorin e tretë të vitit 2020.

Në vazhdim, është paraqitur disponueshmëria e linjave dhe nënstacioneve në SEE gjatë vitit 2020:




Fig. 3-1. Disponueshmëria totale e linjave gjatë vitit 2020




Fig. 3-2. Disponueshmëria totale e linjave gjatë vitit 2020





Fig. 3-3. Disponueshmëria e nënstacioneve gjatë vitit 2020

Ashtu si edhe vitet e mëparshme, me qëllim të arritjes së objektivave të saj KOSTT ka punuar në krijimin e kushteve sa më të mira të punës për të gjithë punëtorët e saj si në rregullimin e hapësirave të punës ashtu edhe në krijimin e kushteve tjera më të mira për punë, duke vazhduar me renovimin e nënstacioneve duke u bazuar në efikasitetin e energjisë, largimin e materialeve të dëmshme si dhe mirëmbajtjen e rregull të tyre. Gjatë vitit 2020 janë rinovuar nënstacionet NS 110kV Lipjani, NS 110kV Deçani, NS 110kV Istogu, dhe NS 110kV Prizreni 3.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Gjithashtu është rinovuar ndërtesa në NS Prishtina 1 dhe janë realizuar shumë projekte që kanë të bëjnë me infrastrukturë ndërtimore të Nënstacioneve të KOSTT.

Siguria fizike në KOSTT, e cila nënkupton mbrojtjen e të gjitha asetëve të kompanisë KOSTT nga kërcënimet me vjedhje apo dëmtime, gjatë vitit 2020 edhe përkundër shumë rasteve të tentim vjedhjes dhe vjedhjeve, është arritur që asetet vitale të mbahen të pacenuara, dhe si rezultat i kësaj nuk është rrezikuar për asnjë moment funksionimi i punës nëpër objekte dhe nënstacione të KOSTT-it, të cilat do të mund të ndikonin në vazhdimësinë e punës.

Janë ndërmarrë një sërë veprimesh në objektet më të atakuara, të cilat kanë pasur impakt pozitiv në sigurinë fizike, si: lëvizja strategjike e rojeve, shtimi i numrit të pikë-rojës, rregullimi i ndriçimit, intensifikimi i inspektimeve etj.

Nga aspekti i sigurisë fizike është kontraktuar punimi i rrethojave në NS Theranda dhe SSH Drenasi dhe ka filluar realizimi këtij projekti.

Në vazhden e zhvillimit të stafit pas aprovimit të politikës për menaxhimin e talenteve, do të punohet në zbatueshmërinë e saj përmes procedurave dhe standardeve më të larta ndërkombëtare, më qëllim që talentet e profileve të nevojshme të joshen, trajnohen dhe zhvillohen.


Konform bashkëpunimit edhe me projektin e USAID për barazi gjinore, në sektorin e energjisë elektrike gjatë vitit 2020 është përgatitur dhe aprovuar Politika për barazi gjinore, me qëllim të promovimit dhe avancimit të vazhdueshëm të barazisë gjinore në veçanti, dhe mos diskriminimit, në përgjithësi si dhe është nxjerr raporti i punës se ekipit mbi gjendjen momentale nga aspekti parametrevë dhe praktikave me të mire për barazi gjinore në KOSTT. Konform të gjatuarave do të punohet strategjia dhe plani i veprimit të promovimit dhe avancimit të vazhdueshëm të barazisë gjinore në veçanti, dhe mos diskriminimit, në përgjithësi.

Duke ditur se KOSTT ka kapacitete njerëzore profesionale të rangut evropian, do të krijohet një platformë e qëndrueshme brenda ri-organizimit të kompanisë, për dhënien e shërbimeve konsulente ndërkombëtare të profilit elektroenergetik, ekonomik dhe juridiko – ligjor.

Gjatë tërë vitit 2020 ka vazhduar puna e grupeve punuese KOSTT-OST për të mundësuar implementimin e Marrëveshjes së Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK). Kjo marrëveshje obligon palët (KOSTT dhe e OST) të punojnë bashkërisht në operimin e bllokut të përbashkët sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja SAFA dhe SOGL si dhe në harmoni me kodet nacionale të rrjetit.

Ky grup punues ka punuar duke i marrë parasysh kërkesat për operimin e LFC të bllokut në dy LFC zona, funksionimin e AFRR sipas marrëveshjes (Marrëveshja e Shkëmbimit të rezervës automatike ndërmjet KOSTT dhe OST) si dhe duke analizuar mundësinë e përfshirjes së funksionit Imbalance Netting në kuadër të rregullimit automatik.

Për të realizuar zbatimin e Marrëveshjes së Bllokut AK, sipas detyrave të përcaktuara për grupet përkatëse, në koordinim të plotë me përfaqësuesit e grupit të OST, është realizuar shkëmbimi i të dhënave për monitorimin e Bllokut në kohë reale për qëllim të monitorimit të ACE. Janë realizuar testimet e funksionimit softuerik të përkrahjes së aFRR me OST, test procedura (pa veprime kthyese në rrjet të fuqisë)

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 22 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

e përkrahjes së aFRR si qëllim i vërtetimit të punës së komunikimit, dhe pajisjeve që ndodhen në mes KOSTT dhe OST, gjë që kanë rezultuar të suksesshme.

Edhe gjatë vitit 2021 do të punohet në ngritjen dhe funksionalizimin e nënstacioneve për kontroll dhe monitorim të plotë nga largësia. Në këtë proces, gjatë vitit 2020 është realizuar funksioni i operimit të nënstacioneve pa personel duke realizuar funksionimin e sistemit SCADA në NS Vushtrri 1 për monitorim dhe kontroll të NS 110/10(20)kV Ilirida nga NS Vushtrri 1 dhe monitorimin e NS 110/10(20)kV Drenas 2 nga SSH Drenas. Këto dy raste janë realizuar si pilot projekt dhe do të shërbejnë si përvojë gjatë punës në vijim për kompletimin e nënstacioneve me qëllimin të funksionalizimit të operimit të nënstacioneve pa personel.

Përkushtimi i KOSTT-it, për arritjen e objektivit të kompanisë siç është përgjegjësia në aspektin e sigurisë dhe mjedisit, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2020. Viti është përmbyllur pa asnjë incident, lëndim të punëtorëve apo emergjencë mjedisore dhe me mirëmbajtjen e certifikimit pas auditimit të jashtëm për Menaxhimin e Sistemit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë OHSAS 18001:2007 dhe Menaxhimin e Sistemit të Mjedisit ISO 14001:2015.

Viti 2020 nga aspekti i sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve ka qenë një sfidë në vete për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia e shkaktuar nga korona virusi Covid-19. Përkundër situatës së krijuar nga pandemia, është arritur me sukses që të menaxhohet përhapja e infeksionit nga Covid-19 dhe ruajtja e shëndetit të punëtorëve. Të gjitha veprimet dhe masat mbrojtëse janë implementuar në përputhje me vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK). Ndër masat mbrojtëse që janë ndërmarrë, kanë qenë: informimi i vazhdueshëm i punëtorëve, dezinfektimi i hapësirave të punës, furnizimi me maska mbrojtëse dhe dezinfektues për duar, mbajtja e distancës dhe reduktimi i stafit në vendet e punës, pa penguar aktivitetet esenciale të KOSTT për të mbajtur besueshmërinë e Sistemit të Transmetimit për furnizim të pandërprerë me energji elektrike.

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga korona virusi Covid-19, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar më pak inspektime në terren dhe kontakte të drejtpërdrejta me punëtorë.

Pandemia në nivel global ka ndikuar edhe në pezullimin e organizimit të trajnimeve, punëtorive dhe konferencave të ndryshme, duke ndikuar drejtpërdrejtë edhe në implementimin e planit të trajnimeve.

Opinionin e auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2019 është pa asnjë kualifikim, duke filluar qysh nga viti 2006. Kjo e arritur dëshmon më së miri punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të gjitha resurseve. Veç kësaj, KOSTT ka kryer me kohë obligimet ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës.


Ndryshimi i kornizës rregullative nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe vendimet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, me qëllim të krijimit të një tregu konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike në Kosovë, si dhe krijimit të kushteve për qasje jo diskriminuese dhe transparente ndaj palëve të treta, ka rezultuar në ndërmarrjen e aktiviteteve nga KOSTT për harmonizimin dhe krijimin e kornizës rregullative funksionale të brendshme kundrejt dispozitave bazë të nxjerra nga institucionet e lartcekura.

Në kuadër të kësaj, KOSTT ka ndërmarr aktivitetet vijuese:

Nr.	Dokumenti	Qëllimi	Vendimi nga ZRrE
1.	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	Ndryshimi dhe plotësimi i Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit lidhur me Kohëzgjatjen e vlefshmërisë së Marrëveshjes për Kyçje.	Shtator 2020. Nuk ka Vendim
2.	Të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR)	Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Rregullës për të Hyrat e OST/OT)	V_1238_2020
3.	Tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit dhe tregut (KOSTT Sh. A.)	Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Rregullës për të Hyrat e OST/OT)	V_1250_2020
4.	Bilanci i Rishikuar Vjetor i Energjisë Elektrike 2020	Në pajtim me Ligjin për Energjinë dhe Licencën e OST	V_1263_2020
5.	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	Në pajtim me Rregullat e Tregut	V_1264_2020
6.	Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive	Në pajtim me Rregullat e Tregut	V_1317_2020
7.	<ul style="list-style-type: none"> - Metodologjia për Rregullat për dimensionimin e FRR në Bllokun LFC AK. - Procedura për shkëmbimin dhe aktivizimin e rezervave për balancim të zonave rregulluese dhe bllokut AK. 	Në pajtim me Ligjin për Energji Elektrike dhe Licencës së OST	V_1318_2020
8.	Rregullat e harmonizuara afatgjata për Alokimin e të drejtave të transmetimit	Në pajtim me Ligjin për Energji Elektrike dhe Licencës së OST	V_1319_2020
9.	Transferimi i të Drejtave dhe obligimeve tek ALPEX	Në pajtim me Ligjin për Energji Elektrike dhe Licencës së OST	V_1332_2020
10.	Plani Zhvillimor i Transmetimit 2020 - 2029	Në pajtim me Ligjin për Energjinë dhe Licencën e OST	V_1336_2020
11.	Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2021	Në pajtim me Ligjin për Energjinë dhe Licencën e OST	V_1320_2020

Tabelë. 3-1. Aktivitetet për harmonizimin dhe krijimin e kornizës rregullative funksionale

Në ndërlidhje me planet e rregullta të punës, KOSTT ka realizuar monitorimin e brendshëm të implementimit të Kodit të Rrjetit për vitin 2020, duke bërë gjithashtu edhe rishikimin e dokumenteve varësisht prej kërkesave ligjore dhe konkluzioneve të nxjerra nga ky aktivitet. Duke u mbështetur në

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 24 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

dispozitat nga Ligji për Energjinë Elektrike, raporti final i Monitorimit të Implementimit të Kodit të Rrjetit për vitin 2019 është dërguar në ZRrE.

Në kuadër të procesit të implementimit të kornizës rregullative të sektorit të energjisë që ndërlidhet me procesin e Integrimi Evropiane, KOSTT vazhdimisht ka qenë dhe është pjesë e procesit të raportimit mbi implementimin e masave ligjore dhe zbatuese të përfshira brenda Agjendës Evropiane për Integrim dhe Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim (PKZMSA) duke mos anashkuar edhe Planin e Vjetor të Punës së Qeverisë së Kosovës (PVPQ) si pjesë ndërlidhëse me këtë proces integruar.


Sipas kërkesave nga legjislacioni primar dhe nga legjislacioni sekondar, dhe sipas afateve të përcaktuara nga ZRRE, KOSTT ka përgatit dhe i ka dorëzuar në ZRRE dokumentet dhe aplikacionet:

- Aplikacionin për Azhurnimet Vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale, raportin e realizimit për vitin 2019 dhe aplikacionin për tarifatat/ngarkesat e energjisë elektrike që do të zbatohen nga data 1 prill 2020 deri më 31 mars 2021.
- Komente ndaj Raportit Konsultativ- Komente ndaj Aplikacionit Fillestar të ZRRE-së, përgatitja e përgjigjeve ndaj komenteve dhe përgatitja e Aplikacionit Final për dërgim në ZRRE.
- Aplikacioni për Tarifatat e KOSTT
- Aplikacioni për Përshtatjet e Rregullta Vjetore 2020/2021.
- Listën e projekteve kapitale dhe Raportin për realizimin e vitit 2020 dhe planifikimin për vitin 2021.

Gjatë vitit 2020, janë nënshkruar Marrëveshjet e Kyçjes edhe me palët ekzistuese siç janë: MK KOSTT - SharrCem, MK KOSTT - Trepça dhe MK KOSTT- Ferronikeli.

Po ashtu janë dërguar shkresa në ZRrE dhe Institucionet relevante lidhur me:

- Kërkesë për Kosto shtesë lidhur me Projektin e konvertimit të rrjetit 10 kV në 20 kV.
- Raportet Tremujore të Pajtushmërisë me kushtet e Licencave për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Raportet mbi veprimtarinë e Operatorit të Sistemit, Operatorit të Transmetimit dhe Operatorit të Tregut.
- Raporti mbi Mangësitë e Sistemeve Matëse dhe Rekomandim për Sistemet Matëse.
- Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara dhe Raportin e Auditorit të pavarur.
- Raportet Mujore për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe Raportin mujor për blerjen e energjisë elektrike balancuese në ankandet ditore të organizuara nga KOSTT.
- Propozimi i çmimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 25 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

- Amandamentimi i Marrëveshjes për blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit” - KOSTT sh. a dhe KEK sh. a, e datës 27.07.2017. Kjo marrëveshje do të mbuloj periudhën prej 01.04.2020 deri më 31.03.2021.
- Raport Vjetor mbi sinjalizimin dërguar në Agjencionin Kundër Korrupsionin.
- Raportet Tremujore lidhur me energjinë e nominuar të BRE-ve, dërguar në Agjencionin e Statistikave të Kosovës.
- Raportet e Derrogimeve për Kodin e Rrjetit, Kodin e Matjes, Rregullat e Tregut dhe Licencën, lidhur me dispozitat të cilat nuk janë në implementim.
- Kërkesa për Derrogim për BAAE 2021-2030 dhe PAGj 2021-2030.
- Kërkesa për aprovimin e amandamentimit të Procedurës për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive.
- Kërkesa për aprovimin e amandamentimit të Procedurës së Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve.
- Kërkesa për aprovimin e Rregullave të Ankandit të SEE CAO.
- Kërkesa për aprovimin e amandamentimit të Kodit të Shpërndarjes dhe Kodit të Matjes së Shpërndarjes.


Të arriturat e KOSTT, respektivisht, progresi që KOSTT ka bërë gjatë vitit 2020, janë paraqitur më detalisht në pikën 2.4 të këtij Raporti, i cili shqyrton implementimin e Planit të Biznesit për vitin 2020.

3.2. Ngjarjet kryesore të vitit

Janar 2020

-Delegacioni nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik të RF të Gjermanisë dhe KfW vizitoi KOSTT- Delegacioni gjerman në krye me zyrtaren e lartë përgjegjëse për Kosovën nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik të Republikës Federale të Gjermanisë znj. Michala Brinkhaus e cila ishte e shoqëruar edhe nga zyrtarë të lartë nga Ambasada Gjermane në Kosovë dhe Banka Gjermane për Zhvillim-KfW, vizituan KOSTT-in më 24 janar 2020. Zv. Kryeshefi I KOSTT z. Kadri Kadriu njoftoi delegacionin e lartë gjerman rreth rëndësisë dhe benefiteve të investimeve gjermane në sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës si dhe rreth sfidave me të cilat përballlet KOSTT në drejtim të integritimit në mekanizmat Evropian të Sistemeve Elektro-energjike, dhe angazhimet që po bëhen në drejtim të avancimit të KOSTT në këtë drejtim. Delegacioni gjerman vlerësoi lartë sukseset e arritura të KOSTT dhe u shpreh i kënaqur me rezultatet nga investimet e realizuara me fondet e Qeverisë Gjermane përmes KfW.

-Përfaqësuesit e Ambasadave të Quintit, Bashkimit Evropian dhe Zvicrës në Kosovë realizuan takim informues në KOSTT- Në takimin e mbajtur me 30 janar 2020 në KOSTT ku të pranishëm ishin gjithashtu edhe përfaqësuesit e institucioneve relevante vendore si: Zyra e Rregullatorit për Energji, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Palët e interesit u njoftuan për së afërmi në

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 26 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

lidhje me rolin e KOSTT në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, statusin dhe hapat e ardhshëm në ndërlidhje me Marrëveshjen e re të Kyçjes me ENTSO-E si dhe themelimin e Bllokut AK Shqipëri-Kosovë. Delegacioni diplomatik vlerësoi lartë punën dhe përkushtimin e KOSTT si dhe shprehën mbështetjen e tyre për KOSTT në vazhden e integrimi rajonale dhe fillimit të operimit të pavarur në kuadër të Bllokut Rregullues të përbërë prej dy zonave rregulluese KOSTT dhe OST Shqipëri.

Shkurt 2020

-KOSTT sh.a nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Zvicrës-SwissGrid – Në kuadër të angazhimeve në funksion të avancimit të partneriteteve, bashkëpunimit dhe integritimit në mekanizmat ndërkombëtar, me 25 shkurt 2020, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimi me Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Zvicrës (SwissGrid).


Swissgrid si anëtar aktiv i Rrjetit të Operatorëve Evropianë të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E) gjithashtu mban rolin e përgjegjës për Qendrën Koordinuese Jug, dhe në kuadër të këtij roli përmes Marrëveshjes së nënshkruar do të mund të sigurojë asistencë teknike si dhe trajnim për punonjësit e KOSTT në fushën e Rregullimit të Frekuencës-Ngarkesës (LFC) si dhe zbatimin dhe funksionimin e Bllokut Rregullues. Ndryshe në janar të vitit 2020 menaxhmentin e lartë i SwissGrid në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z. Yves Zumwald zhvilluan një vizitë në KOSTT ku u diskutua me menaxhmentin për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve.

Mars 2020

-KOSTT pjesë e iniciativës globale #EachforEqual për fuqizimin e gruas - Në funksion të objektivës për barazi gjinore, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas me iniciativën dhe organizimin e Zyrës për Komunikim dhe Relacione me Publikun, KOSTT i është bashkuar kampanjës globale #EachForEqual, për të dhënë kontributin për ndryshim pozitiv duke promovuar të drejta të barabarta gjinore, fuqizimin e gruas dhe inspirimin e gruas për angazhim në sektorin e energjisë.

Prill 2020

-Përmbillet me sukses votimi i Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E - Me datë 20 prill 2020 u përmbyll me sukses votimi i Marrëveshjes së re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, nga Grupi Regional i Evropës Kontinentale (RGCE). Me votimin dhe nënshkrimin që do të pasoj, KOSTT dhe Republika e Kosovës përfundimisht del nga Blloku rregullues SMM (Serbi, Mali i Zi dhe Maqedoni Veriore) dhe i bashkohet Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri-Blloku AK. Me fillimin e implemenimit të Marrëveshjes së re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, KOSTT do të operoj si zonë rregulluese e pavarur brenda Bllokut AK në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale. Alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit dhe menaxhimi i kongjestionëve të rrjetit interkonektiv do të realizohet brenda strukturës së këtij blloku dhe jo më nga EMS (Serbi), ku edhe të hyrat nga këto aktivitete do të mblidhen nga Blloku, përkatësisht nga KOSTT. Ky zhvillim tutje i hap rrugë KOSTT-it për integrimin në tregun rajonal të energjisë, pjesëmarrjes në bursën shqiptare të energjisë (APEX) si dhe vënies në operim të linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 27 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

-Pas suksesit të arritur me votimin e Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E Kryeministri i Kosovës në detyrë vizitoi KOSTT – me 21 prill 2020 Kryeministri i Kosovës në detyrë z. Albin Kurti dhe Ministrja në detyrë e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike znj. Rozeta Hajdari me bashkëpunëtorë kanë vizituar KOSTT-in ku u pritën nga menaxhmenti i lartë. Delegacioni i lartë qeveritar u njoftuan rreth procesit të votimit të Marrëveshjes së re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, nga ana e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit (OST) të vendeve të Grupit Regjional të Evropës Kontinentale (RGCE), trup i ENTSO-E. Me këtë zhvillim tani KOSTT/Republikës së Kosovës do t'i njihen kufijt energjetik si zonë rregulluese brenda Bllokut Rregullues AK me Republikën e Shqipërisë. Delegacioni qeveritar u njoftuan që me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit dhe menaxhimi i kongjestionëve të rrjetit interkonektiv të Kosovës do të realizohet brenda strukturës së Bllokut Rregullues AK dhe jo më nga EMS (Serbi), ku edhe të hyrat nga këto aktivitete do të mbliidhen nga Blloku, përkatësisht nga KOSTT. Ky zhvillim tutje i hap rrugë KOSTT për integrimin në tregun rajonal të energjisë, pjesëmarrjes në bursën shqiptare të energjisë (APEX) si dhe vënies në operim të linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri. Kryeministri në detyrë Kurti shprehu përkrahjen për KOSTT për të gjitha këto procese të pritura në vijim.


Në vazhdimësi të vlerësimeve të suksesit të arritur në votimin e Marrëveshjes së re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, me 22 prill 2020 Ambasadori i Republikës së Shqipërisë z. Qemal Minxhozi si dhe me 7 maj 2020 përfaqësuesit e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë gjithashtu vizituan KOSTT-in.

Qershor 2020

-Nënshkruhet Marrëveshja për Kyçje në Sistemin Transmetues të Kosovës i Hidrocentralit Reverzibil Drini - Ky hidrocentral do të kyçet në nënstacionin e KOSTT, NS Prizreni 2, me ç 'rast do të bëhet edhe rindërtimi i nënstacionit në fjalë I cili mëpastaj do të kalojë në nivel 400 kV. Projekti I kompanisë Eurokos DD sh.p.k. do të ndërtohet në Zhur dhe pritet të kompletohet në fund të vitit 2023.

- Komuna e Rahovecit, Malishevës dhe Therandës me furnizim më të besueshëm dhe cilësor me energji elektrike, ndërkaq Rrjeti i Transmetimit të Kosovës plotëson kriterin e sigurisë së furnizimit N-1 - Që nga viti 2008 kur është ndërtuar për herë të parë nënstacioni 110/35/10(20)kV Rahoveci i lidhur me një linjë të vetme transmetuese 110 kV, me 18 qershor 2020 u përmbyll me sukses projekti i ndërtimit të linjës së re të tensionit të lartë 110 kV me gjatësi prej 16.5 km, e cila shtrihet në 57 shtylla elektrike, duke lidhur këtë nënstacion me nënstacionin 110/35/10(20)kV Theranda. Falë realizimit të këtij projekti në vlerë prej më se 1.43 milion Euro, i cili u bashkë-financua nga ana e KOSTT dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), qytetarët e Komunës së Rahovecit, Malishevës dhe Therandës, do të kenë furnizim më të besueshëm dhe më cilësor me energji elektrike, nga aspekti i transmetimit. Ky projekt gjithashtu do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve transmetuese, uljen e energjisë së padërguar te konsumatorët si dhe në optimizimin e proceseve të mirëmbajtjes së linjave transmetuese. Ndërkaq me vënien në operim të linjës, tani përfundimisht Rrjeti i Transmetimit të Kosovës plotëson kriterin teknik të sigurisë së furnizimit N-1.

- Nënshkruhet Marrëveshja e re e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E - Pas votimit të suksesshëm në muajin prill nga ana e Grupit Regjional të Evropës Kontinentale (RGCE), më 30 qershor 2020 Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala nënshkroi Marrëveshjen e re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E. Me fillimin e implementimit të marrëveshjes KOSTT do të operoj si zonë rregulluese e pavarur brenda Bllokut AK me Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale. Marrëveshja e re e Kyçjes

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 28 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

KOSTT/ENTSO-E pritet të fillojë së zbatuari në vjeshtë të këtij viti pas përfundimit të përgatitjeve teknike të Operatorëve të Sistemit Transmetues të Evropës Kontinentale dhe Koordinatorit Swissgrid (Operatori i Sistemit Transmetues të Zvicrës), derisa KOSTT ka realizuar të gjitha përgatitjet teknike operative për të qenë i gatshëm për fillimin e operimit të pavarur.


- Realizohet vizitë pune në Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Republikës së Shqipërisë (OST) - Më 11 Qershor 2020, menaxhmenti I KOSTT realizoi vizitë pune në Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Republikës së Shqipërisë (OST), në Tiranë. Në takim u diskutuan tema me interes për të dyja institucionet si: shkëmbimi i informatave dhe përgatitjet e operimit të Bllokut Rregullues Kosovë - Shqipëri (Blloku AK); zhvillimi i tregut të përbashkët të energjisë elektrike Kosovë – Shqipëri; harmonizimin e planeve zhvillimore në rrjetin e transmetimit; avansimin e sistemeve telekomunikuese si dhe mundësitë e komercializimit të fibrave optike në linjat interkonektive

Korrik 2020

-Në 14 vjetorin e themelimit, KOSTT prezanton të arriturat kryesore - Të arritura të shumta e karakterizojnë udhëtimin 14 vjeçar të KOSTT dhe kjo është meritë e përkushtimit profesional të secilit punonjës në drejtim të përbashkës së objektivave strategjike të kompanisë. Me rastin e 14 vjetorit të themelimit të kompanisë, me datë 1 korrik 2020 KOSTT prezantoi të arriturat kryesore si dhe pasqyrën e Rrjetit të Transmetimit të Kosovës. Me këtë rast KOSTT gjithashtu ndau mirënjohje për punëtorët e përzgjedhur.

-Nënshkruhet kontrata në mes të KOSTT dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) për shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës – Me 2 korrik 2020 u nënshkrua kontrata për shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës (mFRR) në mes të Kryeshefi Ekzekutiv të KOSTT z.Illir M.Shala dhe Administratorit të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) z.Benet Beci në bazë të së cilës KOSTT do të blejë shërbimet mFRR nga KESH me qëllim të balancimit të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës. Me qëllim të operimit stabil të sistemit elektroenergjetik si dhe balancimit të sistemit në kohë reale, KOSTT në bazë të Ligjit të Energjisë Elektrike dhe licencës për operimin e sistemit të transmetimit, është i obliguar të sigurojë shërbimet ndihmëse, pjesë e së cilës është edhe mFRR derisa balancimi i sistemit është i domosdoshëm gjithashtu për funksionimin e KOSTT si zonë rregulluese e pavarur, në kuadër të Bllokut Rregullues me Shqipërinë (Blloku AK) si dhe në punë paralele me sistemet tjera të Evropës Kontinentale. Zbatimi i kontratës ndërmjet KOSTT dhe KESH për shërbimet mFRR do të fillojë me fillimin e zbatimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E dhe operimit të KOSTT si Zonë Rregulluese brenda Bllokut AK, ndërkaq procesi është zhvilluar në pajtim me Procedurën për Tregtimin e Energjisë, të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

- U mbajt mbledhja konstituive e përbërjes së re të Bordit të Drejtorëve të KOSTT - Me 21 korrik 2020 u mbajt mbledhja konstituive e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, konform vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.07-V-023, i cila u miratua me datë 10 korrik 2020, në përbërje të Kryesuesit të Bordit z. Jeton Mehmeti dhe anëtarët z. Arben Dodaj dhe z. Nebih Zariqi si dhe sipas pozitës dhe funksionit Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it z. Ilir M. Shala. Konstituimi I Bordit të Drejtorëve, do të ndikojë pozitivisht në zbatimin e obligimeve ligjore dhe atyre të përcaktuara me licencë lëshuar nga ZRrE, në funksion të operimit të sigurtë dhe të besueshëm të Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike në Kosovë si dhe mbarëvajtjen e

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 29 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

proceseve, nëpër të cilat po kalon KOSTT. Anëtarët e tjerë pritet të përzgjedhen pas rishpalljes së konkursit nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe përzgjedhjes së tyre nga Kuvendi i Kosovës.


Shtator 2020

-Nënshkruhet kontrata në mes të KOSTT dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) për shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës, për rregullimin zbritës - Në vazhdimësi të parapërgatitjeve për fillimin e operimit të pavarur të KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut AK dhe të punës paralele me sistemet tjera të Evropës Kontinentale më 9 shtator 2020 në Prishtinë, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Illir M.Shala dhe u.d. Kryeshefi Ekzekutiv i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) z.Luigj Imeri, nënshkruan kontratën për shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës (mFRR), për rregullimin zbritës. Bazuar në legjislacionin vendor si dhe në rregullativat e ENTSO-E, KOSTT si Operator i Sistemit të Transmetimit është i obliguar që të siguroj operimin stabil dhe të besueshëm të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës si dhe të balancoj sistemin duke siguruar shërbimet e rezervës për restaurimin e frekuencës, të njohura si shërbimet ndihmëse. Kontrata ndërmjet KOSTT dhe KEK për mFRR) për rregullimin zbritës, do të filloj së zbatuari me fillimin e zbatimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E dhe operimit të KOSTT si Zonë Rregulluese brenda Bllokut AK, ndërkaq procesi është zhvilluar në pajtim me Procedurën për Tregtimin e Energjisë, të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

- Nënshkruhet Marrëveshja për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të Kosovës të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtërishme të energjisë - Me 11 shtator 2020 u nënshkrua Marrëveshja për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të gjeneratorit me erë KITKA, zgjerimi kapaciteteve gjeneruese ekzistuese për 20 MW, në mes të Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT z. Ilir M. Shala dhe drejtori I Dardana Invest z. Sait Vokshi. Investimet e vazhdueshme të cilat I ka realizuar KOSTT në Sistemin e Transmetimit të Kosovës kanë krijuar kushte të favorshme për akomodimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike dhe njëherit përkrahjen e integritit të burimeve të ripërtërishme në rrjetin e transmetimit. Pas shqyrtimit të aplikacionit nga KOSTT dhe nënshkrimit të marrëveshjes, kapacitetet e zgjeruara të KITKA planifikohet të ndërtohen deri në vitin 2022 kur dhe do të kyçen në rrjetin e tensionit të lartë 110 kV.

-KOSTT i bashkohet UNICEF Kosova dhe Kosovo CSR Network në kampanjën #united4children dhe #back2school - Në mbështetje të përkushtimit të vazhdueshëm të KOSTT sh.a, në implementimin e primeve të Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave, si për nga aspekti i veprimtarisë që ushtron, ashtu edhe me përkrahje filantropike të kohëpaskohshme për komunitetin duke bërë përpjekje për të ndikuar në zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenien e shoqërisë, KOSTT iu bashkua kampanjës së UNICEF dhe Kosovo CSR Network #united4children dhe #back2school që fëmijët të vihen në qendër të planeve të reagimit dhe rimëkëmbjes nga COVID-19 në Kosovë.

-Kryeministri i Republikës së Kosovës priti në takim Bordin e KOSTT - Me 18 Shtator 2020, Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, priti në takim Bordin e Drejtorëve të KOSTT-it, kryesuar nga kryesuesi i Bordit, z. Jeton Mehmeti, anëtarët z. Arben Dodaj, z. Nebih Zariqi, z.Illir M. Shala - Kryeshef Ekzekutiv ku u njoftua për zhvillimet e fundit në sektorin e energjisë dhe stabilitetin energjetik në vend. Me këtë rast, Kryeministri i Kosovës shprehu mbështetjen për KOSTT si dhe theksoi që “stabiliteti energjetik është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit, i rritjes së investimeve të brendshme dhe atyre të jashtme dhe në funksion të mirëqenies së qytetarëve”.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 30 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

-KOSTT merr pjesë në punëtorinë me temën “Dekarbonizimi i Energjisë në Kosovë” - Më 22 Shtator 2020, nën organizim të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW dhe kompanisë Lumenion GmbH dhe me pjesëmarrje të shumë akterëve nga fusha e energjisë në Kosovë, u realizua në mënyrë virtuale Punëtoria me temën Dekarbonizimi i Energjisë në Kosovë ku ishin prezent zv. Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Kadri Kadriu si panelist dhe z. Gazmend Kabashi Menaxher i Zyrës për Planifikim Afatgjatë dhe Zhvillim. Përmes prezantimit me temën Evolucionit të Sistemit të Energjisë në Kosovë, z. Kadriu shpali të arriturat dhe sfidat e KOSTT në drejtim të bërjes Zonë/Bllok Rregullues i Pavarur e cila rezultoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Re për Kycje KOSTT-ENTSO-E, si dhe zgjerimin e kapaciteteve transmetuese në funksion të akomodimit të mëtutjeshëm të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë Elektrike dhe sfidat e operimit në funksion të integritit në shkallë të gjerë të BRE. Në Punëtori u prezantuan rezultatet e studimit para-fizibilitetit për sistemet e akumulimit të energjisë me temperature të lartë në mbështetje të dekarbonizimit të Termocentralit Kosova A, e realizuar nga Lumenion GmbH si dhe shkëmbime të njohurive në lidhje me kushtet teknologjike, ekonomike, financiare dhe rregullatore për sistemet akumuluese të energjisë.

- RGCE vlerëson që KOSTT ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara me marrëveshjen e re të kyçjes KOSTT/ENTSO-E dhe që marrëveshja të hyj në fuqi - Në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2020, RGCE (Regional Group for Continental Europe) trup i ENTSO-E, ka vlerësuar që KOSTT ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara me marrëveshje dhe është votuar që Marrëveshja e re e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E të hyj në fuqi. Me hyrjen në fuqi të marrëveshjes, fillojnë përgatitjet teknike me Qendrën Koordinuese SwissGrid si dhe me OST-të fqinje për t'i mundësuar KOSTT-it fillimin e operimit si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut AK.


Tetor 2020

-Themelohet Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX) - Më 5 tetor 2020 në Prishtinë, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it z. Ilir M.Shala dhe Administratori i Operatorit të Sistemit të Transmetimit Shqiptar (OST) z. Skerdi Drenova nënshkruan Marrëveshjen e Aksionarëve për themelimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) si dhe miratuan Statutin e saj.

Themelimi i ALPEX shënon një standard të ri të operimit në sektorin e energjisë, i cili do të garantojë më shumë transparencë dhe konkurrencë në tregun e energjisë elektrike si dhe do të ndikojë në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, shfrytëzimin më efikas të kapaciteteve ndërkufitare si dhe pritjet që çmimi i energjisë elektrike do të ulet për qytetarët e të dyja vendeve.

- Ambasadori i RF Gjermane z. Rohde vizitoi KOSTT – më 8 tetor 2020 Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Sh.T z.Jörn Rohde me bashkëpunëtorë vizitor KOSTT-in me ç ‘rast u njoftoi për zhvillimet e fundit, si ajo e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT - ENTSO-E, themelimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, lëshimin në operim të plotë të linjës transmetuese 400 kV, Kosovë - Shqipëri, si dhe për sigurinë e furnizimit me energji elektrike në tërë Republikën e Kosovës. Me këtë rast ambasadori z. Rohde shprehu urimet dhe përgëzimet më të sinqerta me arritjet dhe sukseset e KOSTT-it si dhe vlerësoi lartë përkushtimin dhe punën profesionale të menaxhmentit dhe stafit si dhe gatishmërinë për përkrahje të mëtutjeshme.

-Kryeshefja Ekzekutive e Agjencise për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit vizitoi KOSTT ku u njoftua për të arriturat dhe planet e KOSTT në fushën e barazisë gjinore. Që nga nëntori 2018, KOSTT ka

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 31 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

bashkëpunuar me USAID, përmes Programit të Shërbimeve përkrahëse për të ndihmuar në zhvillimin dhe zbatimin e një plani të veprimi, për të përfshirë praktikën më të mira të barazisë gjinore.


- **KOSTT dhe KEDS nënshkruan Marrëveshjet e Kyçjes për nënstacionet e reja, NS 220/10(20) kV Malisheva dhe NS 110/10(20) kV Ferizaj 3** – Me 12 tetor 2020 Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M.Shala dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KEDS Energy z. Alper Erbas nënshkruan Marrëveshjet e Kyçjes, konform Metodologjisë së Taksave të Kyçjes, për nënstacionet e reja: NS 220/10(20) kV - Malisheva dhe NS 110/10 (20) kV - Ferizaj 3. Me ndërtimin e këtyre nënstacioneve, do të përmirësohet cilësia e furnizimit me energji elektrike për të gjithë konsumatorët e këtyre rajoneve si dhe është parakusht për zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik.

-**KOSTT i bashkohet partneritetit global për fuqizimin e të rinjve “Generation Unlimited”** - Në vazhdimësi të përgjegjësishë shoqërore korporative, me 14 tetor 2020 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të KOSTT dhe Rrjetit CSR Kosova nëpërmes së cilit KOSTT i bashkohet partneritetit global për fuqizimin dhe aftësimin e rinjve, për t'i përgatitur për të ardhmen e tyre. Në kuadër të projektit Generation Unlimited në Kosovë (K-GenU) i cili përkrahet nga UNICEF Kosovë dhe nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), KOSTT do të kontribuojë në fuqizimin, zhvillimin dhe ofrimin e shkathtësive për të rinjtë e moshës deri në 24 vjeç, nëpërmjet skemës së punës praktike, duke respektuar po ashtu edhe barazinë gjinore.

-**KOSTT nënshkruan memorandum mirëkuptimi me Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit Hasan Prishtina** – Me 14 tetor 2020 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT z. Ilir M.Shala dhe Dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) të Universitetit Hasan Prishtina, prof. asoc. Dr. Isak Shabani, për ndarjen e bursave për studentët e rregullt të FIEK, me qëllim të përkrahjes dhe motivimit të studentëve për përfundimin e studimeve. KOSTT do të ndaj bursa për 10 studentë, në vlerë prej 100 EUR në muaj, për vitin akademik 2020/21, për 12 muaj, në harmoni me kriteret e përcaktuara në konkursin që do të shpallet për bursa.

- **Ambasadori i Norvegjisë z. Grøndahl vizitoi KOSTT** - Ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Sh.T z. Jens Erik Grøndahl vizitoi KOSTT-in me 21 tetor 2020 me ç ‘rast u njoftua për sukseset e KOSTT në operimin e pavarur si Zonë Rregulluese, brenda Bllokut Rregullues Kosovë - Shqipëri, për themelimin e Bursës Shqiptare të Energjisë ALPEX si dhe për sigurinë e furnizimit me energji elektrike në tërë Republikën e Kosovës, në aspektin e transmetimit.

-**Nënshkruhet Marrëveshja për Procesin e Shkëmbimit të të Dhënave për Barazim Përfundimtar të Energjisë së Shkëmbyer ndërmjet dy zonave rregulluese OST dhe KOSTT** - me datë 30 Tetor 2020, në Tiranë zv. Kryeshefi Ekzekutiv I KOSTT z. Kadri Kadriu nënshkroi me OST Shqipëri Marrëveshjen për Procesin e Shkëmbimit të të Dhënave për Barazim Përfundimtar të Energjisë së Shkëmbyer ndërmjet dy zonave rregulluese të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe Memorandumin për Metodologjinë e Llogaritjes së Kapaciteteve Neto të Transmetimit, ndërmjet dy zonave rregulluese KOSTT dhe OST. Me nënshkrimin e këtyre dy marrëveshjeve KOSTT dhe OST dakordohen të zbatojnë rregullat dhe rekomandimet ENTSO-E për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë, duke respektuar "Rregulloren Nr. 714/2009 të Parlamentit Evropian mbi Kushtet për Hyrjen në Rrjetin për Shkëmbimet Ndërkufitare të Energjisë Elektrike", përkatësisht Rregulloren (EC) 714 / 2009 të Parlamentit Evropian.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 32 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Nëntor 2020

- **Mustafë Hasani merr detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT** - Me vendimin e Bordit të Drejtorëve të KOSTT sh.a të datës 6 nëntor 2020, z. Mustafë Hasani mori detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT. Pas vendimit pozitiv të instancës së parë të Gjykatës Themelore si dhe të instancës së dytë të Gjykatës së Apelit me ç’rast vendimi për rikthimin e z. Mustafë Hasani në vendin e punës Kryeshef Ekzekutiv është bërë i formës së prerë, Bordi i Drejtorëve të KOSTT në përbërje të të gjithë anëtarëve të Bordit, në takimin e datës 6 nëntor 2020 vendosi për zbatimin e urdhrit të Gjykatës. z. Mustafë Hasani me profesion Doktor i Shkencave të Ekonomisë mban përvojë shumë vjeçare në pozita të ndryshme udhëheqëse në institucionet vendore. Z. Hasani ka mbajtur pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT nga dhjetori i vitit 2015 deri në gusht të vitit 2017. Ndërkaq paraprakisht ka mbajtur pozitën e Drejtorit Gjeneral në Administratën Tatimore të Kosovës, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencionit për Promovimin e Investimeve, Drejtor i Bordit të Trafikut Urban dhe Drejtor i Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat në Ministrinë e Financave. Z. Hasani gjithashtu ka qenë i angazhuar në projekte të ndryshme të Komisionit Evropian si dhe si ligjërues i lëndëve ekonomike në kolegje private në Kosovë.


-**Miratohet raporti vjetor financiar i KOSTT nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Transfere** - Në mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Transfere të mbajtur në Kuvendin e Kosovës, Kryesuesi i Bordit të KOSTT z. Jeton Mehmeti dhe Kryeshefi Ekzekutiv z. Mustafë Hasani, prezantuan para deputetëve Raportin vjetor financiar të KOSTT për vitin 2018 dhe 2019. Pas diskutimeve dhe trajtimit të disa çështjeve me interes nën përgjegjësinë e KOSTT, Raporti financiar për vitet 2018 dhe 2019 unanimisht u votua nga anëtarët e Komisionit.

- **KOSTT dhe KEDS/KESCO bashkërendojnë përgatitjet teknike për fillimin e operimit të pavarur të KOSTT si Zonë Rregulluese brenda Bllokut AK** – Në kuadër të bashkërendimit të aktiviteteve dhe përgatitjeve për fillimin operimit të pavarur të KOSTT si Zonë Rregulluese brenda Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë si koordinimin e aktiviteteve për sigurimin e transaksioneve ndërkufitare, me 2 dhjetor 2020 Kryeshefi Ekzekutiv I KOSTT z. Mustafë Hasani me bashkëpunëtor realizuan një takim me përfaqësuesit nga KEDS/KESCO në krye me z. Husejin Ozen. Në takimin e mbajtur me datë 1 dhjetor 2020, të RGCE (Regional Group of Continental Europe) është dakorduar që fillimi i operimit të KOSTT si Zonë Rregulluese brenda Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë, pra fillimi i implementimit të Marrëveshjes së Kyçjes ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E të bëhet me datën 14 dhjetor 2020 dhe si rezultat u diskutuan një mori çështjesh në funksion të furnizimit stabil me energji elektrike në Republikën e Kosovës.

Dhjetor 2020

-**Mbahet Asambleja e Përgjithshme e Bursës Shqiptare të Energjisë ALPEX** – Me datë 3 dhjetor 2020, në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të ALPEX, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani dhe Administratori i Përgjithshëm i OST Shqipëri z. Skerdi Drenova, në cilësinë e aksionarëve të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) miratuan Programin dyvjeçar të Zhvillimit Ekonomik të ALPEX. Me këtë l është hapur rrugë ndërmarrjes së të gjitha veprimeve për të operacionalizuar ALPEX.

-**Vazhdon bashkëpunimi I frytshëm në mes të KOSTT dhe FIEK** – Në vazhdimësi të bashkëpunimit të frytshëm në mes të KOSTT dhe Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) të Universitetit “Hasan Prishtina” me 11 dhjetor 2020 u realizua një takim në mes të Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT z. Mustafë Hasani me bashkëpunëtorë dhe dekanit të FIEK prof. asoc. Dr. Isak Shabani, me bashkëpunëtorë.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 33 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Në kuadër të takimit, u diskutua rreth bashkëpunimit të frytshëm në mes të dy institucioneve si dhe avancimin e bashkëpunimit të gjertanishëm me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve profesionale të të rinjve, kuadër i cili do të shërbejë në të mirë të zhvillimit të sektorit të energjisë në Kosovë, në të ardhmen.


- Fillon operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë – Me rastin e fillimit të operimit të KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë me datë 14 dhjetor 2020 menaxhmenti në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z. Mustafë Hasani si dhe Bordi i KOSTT në krye me Kryesuesin z. Jeton Mehmeti pritën në takim Kryeministrin e Kosovës z. Abdullah Hoti dhe Ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit z. Blerim Kuçi, me bashkëpunëtorë. Me këtë rast, delegacioni i lartë i Qeverisë së Republikës së Kosovës u njoftuan për së afërmi me përgatitjet profesionale që janë realizuar nga ana e KOSTT për fillimin e implementimit të Marrëveshjes së re për Kyçje KOSTT/ENTSO-E që kanë mundësuar që KOSTT përfundimisht të filloj të operoj me të gjitha të drejtat e barabarta me homologët e tjerë ndërkombëtar, sipas standardeve evropiane për operim. Kryeministri i Kosovës z. Abdullah Hoti përgëzoi KOSTT-in për këtë të arritur dhe theksoi se “Mbështetja e Qeverisë për sektorin e energjisë do të jetë maksimal, ngaqë stabiliteti energjetik është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit, rritje të investimeve të brendshme dhe të atyre të jashtme, si dhe në funksion të mirëqenies së qytetarëve.”

- Funkcionalizohet linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri - Pas më shumë se katër vite që nga përfundimi i ndërtimit të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri në të dy anët e kufirit, me 14 dhjetor 2020 përfundimisht linja e njohur si “Autostrada Energjetike Kosovë-Shqipëri” komercialisht është vënë në funksion. Kjo vie si rezultat i fillimit të operimit të KOSTT si Zonë rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë. Vënia në operim e linjës interkonektive të tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri do të ketë impakt pozitiv në optimizimin e dy sistemeve, rritjen e kapaciteteve transmetuese, rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemeve elektroenergjetike të Kosovës, Shqipërisë dhe regjionit si dhe do të ndikojë në zhvillimin e tregut të të dy vendeve si dhe tregut rajonal të energjisë elektrike.

Në një video lidhje direkte e cila u realizua me OST Shqipëri, Kryesuesi i Bordit të KOSTT z. Jeton Mehmeti dhe zv. Kryeshefi i KOSTT z. Kadri Kadriu shprehën falënderimin e tyre të veçantë për bashkëpunimin e vazhdueshëm profesional nga ana e menaxhmentit të OST Shqipëri me ç’rast u theksua që angazhimi shumë vjeçar i dy operatorëve KOSTT dhe OST sot është kurorëzuar me operacionalizimin e Bllokut AK, linjës interkonektive 400kV Kosovë-Shqipëri si dhe projekteve tjera të përbashkëta në zhvillim siç është bursa e energjisë ALPEX.

Përveç menaxhmentit të OST, prezent ishin edhe Kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama dhe Ministra e Energjetikës e Shqipërisë znj. Belinda Balluku.

-KOSTT dhe MEPSO (Maqedoni e Veriut) krijojnë kushte për tregtim të drejtpërdrejtë të energjisë elektrike në mes të dy vendeve – Me 14 dhjetor 2020, Operatorët e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe të Maqedonisë së Veriut (MEPSO), nënshkruan Marrëveshjen Operacionale (Operational Agreement) për organizimin e ankandeve për alokimin e kapaciteteve interkonektive, duke krijuar kështu kushte për tregtim të drejtpërdrejt të energjisë elektrike në mes të dy vendeve. Marrëveshja u nënshkrua nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani dhe Drejtori gjeneral i MEPSO z. Kushtrim Ramadani. Ankandet në emër të të dy operatorëve do të realizohen nga CAO (Coordinated Auction Office for SEE/Zyra për Ankandin e Koordinuar të kapaciteteve interkonektive

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 34 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

(ndërkufitare) për EJL), ku KOSTT dhe MEPSO janë themeluese dhe aksionare së bashku edhe me Operatorët e Sistemit të Transmetimit nga Shqipëria (OST), Mali i Zi (CGES), Greqia (IPTO), Kroacia (HOPS), Bosnja dhe Hercegovina (NOSBiH) dhe Turqia (TEIAS).

-Nënshkruhen Marrëveshjet për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të Kosovës të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë - më 21 dhjetor 2020 Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani dhe drejtori i kompanisë Air Energy 2 z. Kenan Guler, nënshkruan Marrëveshjet për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë me erë “PE Kamenica-1, 34.8 MW” dhe “PE Kamenica-2, 34.8 MW” dhe me diell “PS Kamenica-3, 30MW”, me kapacitet total gjenerues prej 99.6 MW. Të tri parqet e energjisë së ripërtëritshme do të kyçen në rrjetin transmetues 110 kV përmes linjës së re 110 kV me gjatësi rreth 25 km, e cila do të lidhet në NS 110/10(20)kV Gjilani 5. Kyçja në këtë pjesë të rrjetit transmetues të këtij kapaciteti të madh nga burimet e ripërtëritshme, do të mundësoj operim të sigurt si të rrjetit transmetues ashtu edhe të gjeneratorëve të kyçur. Ndërtimi i stacioneve gjeneruese në fjalë planifikohet të filloj në vitin 2021, ndërsa gjenerimi i megavatëve të parë në fund të vitit 2024.

- Ekipi i KFOR për Monitorim dhe Ndërlidhje vizitoi KOSTT - Menaxhmenti i lartë i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z. Mustafë Hasani, me datë 21 dhjetor 2020 pritën në takim Ekipin e KFOR për Monitorim dhe Ndërlidhje, në krye me Parker Mooney, Komandant rajonal qendër.


Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, përfaqësuesit nga KFOR u informuan nga afër në lidhje me implementimin e Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E, operimin e KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut AK si dhe funksionimin dhe sfidat aktuale të operimit të Sistemit të Transmetimit.

-KOSTT përmbyll vitin 2020 me suksese historike për kompaninë dhe gjithë sektorin e energjisë së Republikës së Kosovës - KOSTT ka përmbyllur vitin 2020 me suksese të jashtëzakonshme të cilat janë arritur falë angazhimit dhe përkushtimit shumëvjeçar. Këto suksese përbëjnë arritje historike jo vetëm për kompaninë por edhe për gjithë sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës.

- Pas një procesi të gjatë disa vjeçar Marrëveshja e re e Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, hyri në fuqi më 14 Dhjetor 2020. Me këtë, më në fund u bë realitet operimi i pavarur i KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë

- Pas më shumë se katër vite që nga përfundimi i ndërtimit të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri në të dy anët e kufirit, më 14 Dhjetor 2020 përfundimisht linja e njohur si “Autostrada Energjetike Kosovë-Shqipëri” komercialisht u vu në funksion. Vënia në operim e linjës interkonektive të tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri ka impakt pozitiv në optimizimin e dy sistemeve, rritjen e kapaciteteve transmetuese, rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemeve elektroenergjetike të Kosovës, Shqipërisë dhe regjionit si dhe ndikon në zhvillimin e tregut të të dy vendeve si dhe tregut rajonal të energjisë elektrike.

-Themelimi i Bursës Shqiptare e Energjisë shënon një standard të ri të operimit në sektorin e energjisë. Një institucion i rëndësishëm për zhvillimin e tregut konkurrues të energjisë elektrike për të dyja vendet Kosovë dhe Shqipëri, përmes së cilit do të sigurohet transparencë, konkurrencë në treg dhe shfrytëzim efikas i kapaciteteve interkonektive, në përputhje me politikat shtetërore të të dyja vendeve, legjislacionin evropian dhe obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 35 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Në përmbyllje të suksesshme të vitit 2020 u ndanë mirënjohje për punonjësit e angazhuar në procesin e fillimit të implementimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E dhe fillimin e operimit të KOSTT si zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë.

3.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances

3.3.1. Bilanci i planifikuar dhe e realizuar për Janar-Dhjetor 2020

Detyra e operimit të sistemit gjatë vitit 2020 ka qenë krijimi i kushteve për implementimit të planeve paraprakisht të aprovuara të palëve tregtare sipas Bilancit 2020 (Nga muaji Mars është bërë rishikimi i Bilancit, me kërkesën e KEK për shkak të pamundësisë së riparimeve të blloqeve në Kosovë B, si pasojë e pandemisë). Në vijim janë paraqitur disa të dhëna bazuar në analizën e bilancit të planifikuar dhe të realizuar për vitin 2020.

Vlerat janë sistemuar në formën tabelare për periudhën (Janar-Dhjetor) 2020, ku vlerat e planifikuara dhe të realizuara janë paraqitur në sasi të MWh, si dhe është treguar përqindja e realizimit në raport me planin për periudhën relevante.

Nga **Error! Reference source not found.** vërehet se prodhimi vendor ishte më i lartë se plani për 640%. Ka p asur ulje të importit për 8,39% dhe rritje të eksportit për 176,42% krahasuar me atë të planifikuar. Konsumi neto i Kosovës ka qenë më i ultë se plani për 3,11%.

Humbjet në transmision kanë qenë më të ulëta për 3,19% krahasuar me ato të planifikuara, gjë që paraqet një performancë pozitive të sistemit. Në këtë kanë ndikuar: zhvillimi, topologjia rikonfigurimet dhe optimizimi i rrjetit të transmetimit.

Gjatë kësaj periudhe, KOSTT mundësoi realizimin e të gjitha planeve të miratuara të palëve tregtare si prodhuesve TC KEK, HC Ujmani, HC Lumbardhi, Air Energy Kitka furnizuesit publik KESCO, konsumatorëve të mëdhenj të lidhur në rrjetin transmetues Ferronikeli, Sharr Cem dhe Trepça. Pra nuk ka pasur ankesa në realizimin e kërkesave të palëve tregtare për shkak të rrjetit transmetues.

Të dhënat e planifikuara janë paraqitur bazuar në dokumentin e Bilancit të' rishikuar Vjetor të Energjisë Elektrike 2020, ndërsa të dhënat e realizuara janë marrë nga pikat matëse dhe të transferuara në kufirin elektrik të rrjetit transmetues të Kosovës.

Muajt MWh	Janar-Dhjetor 2020		
	E planifikuar	E realizuar	Real/Plan%
(1) TC Kosova A	1 987 763	2 222 196	111.79
(2) TC Kosova B	3 666 948	3 907 292	106.55
(3) HC Lumbardhi	105 000	48 991	46.66
(4) HC Ujmani	97 000	63 344	65.30
(5) Parku i erës-KITKA	95 521	91 184	95.46
*(6) = 1+2+3+4+5 Prodhimi në hyrje të transmisionit	5 952 232	6 333 007	106.40
(7) Devijimi	0	- 315 977	
(8) Eksporti	464 224	1 283 206	276.42
(9) Importi	916 034	839 209	91.61
(10) = 6-7-8+9 Energjia në disponim	6 404 043	6 204 987	96.89
(11) Distribucioni	5 206 188	4 909 813	94.31
(12) Ferronik e li	429 240	317 980	74.08
(13) Sharri	70 000	56 868	81.24
(14) Trepça	26 400	8 273	31.34
(15) Mijet dhe konsum jasht KEK	109 166	149 357	136.82
(16) Humbjet për konsumin e Veriut	310 464	328 881	105.93
(17) Shpenzimet vetanake të TC nga transmisioni (LP290, B1, B2, T12, T34, T35, T45)	135 579	320 541	236.42
(18) = 11+12+13+14+15+16+17 Kërkesa neto	6 287 038	6 091 714	96.89
(19) Humbjet në transmissiön	117 005	113 273	96.81
(20) = 18+19 Kërkesa gjithsej	6 404 043	6 204 987	96.89

Tabelë. 3-2. Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike me të dhëna të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2020

Disa prej të dhënave kryesore nga Tabelë. 3-2 janë ilustruar edhe në diagramin në vijim, pra janë paraqitur kërkesa (konsumi), prodhimi neto i Kosovës, importi dhe humbjet teknike në rrjetin transmetues të Kosovës:




Fig. 3-4. Bilanci i planifikuar dhe i realizuar 2020

Në vazhdim, në njësinë e energjisë në GWh, është paraqitur figurativisht bilanci i shpërndarjes së gjithë energjisë elektrike që hynë në rrjetin transmetues të Kosovës drejt destinacioneve për periudhën Janar-Dhjetor 2020.

Ne Fig. 3-5 është paraqitur diagrami i bilancit të realizuar elektroenergetik Janar-Dhjetor 2020 (GWh)





Fig. 3-5. Bilanci i realizuar elektroenergetik Janar-Dhjetor 2020

3.4. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

Nr	Indikator		Janar-Dhjetor 2019	Janar-Dhjetor 2020	3-3 2020/2019(%)	Caku	Komenti
T1	Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/periudhën e raportimit)		134.83	79.18	58.73	Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhën aktuale)/(AIT për periudhën e kaluar) < 1	Koha mesatare e mos furnizimit të konsumatorëve për të cilën shkaktar ka qenë KOSTT, ka qenë më e ultë për 41,27% gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019.
T2	Numri i ankesave për tension		2	2.00		Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhën e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtë.
T3	Numri i ankesave për matje		0	0			
T4	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë)	Import	35.72	40.88	114.45	30MWh/h tërheqje jashtë programit të deklaruar	Vlera mesatare e devijimeve ka qenë në import (tërheqje nga sistemi) 14,45% më e lartë se në periudhën e njëjtë 2019, ndërsa eksport (shtyrje në sistem) 13.51% më e ultë se sa periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.
		Eksport	5.97	5.17	86.49	30MWh/h shtyrje jashtë programit të deklaruar	
T5	Humbjet në transmision (GWh)		108.77	113.27	104.14		Humbjet në transmision kanë qenë më të larta për 4,14% krahasuar me vitin 2019. Kanë qenë më të larta ngase hyrjet në rrjetin e transmetimit (prodhimi dhe hyrjet nga interkoneksioni) kanë qenë për 7.9% më të larta

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 39 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vlerat konkrete të indikatorëve teknik të performancës së sistemit për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020, të cilët janë treguesi më i mirë se si është implementuar plani i aprovuar i bilancit vjetor 2020, në krahasim me të njëjtën periudhë kohore të vitit paraprak 2019.

Nga rezultatet e fituara shihet se koha mesatare e mos furnizimit të konsumatorëve ka qenë më e ultë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019.

- (T1) Koha mesatare e mos furnizimit të konsumatorëve për të cilën shkaktar ka qenë KOSTT, ka qenë më e ultë për 41.27% gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 krahasuar me periudhën e njëjtë 2019.
- (T4) Vlera mesatare e devijimeve ka qenë në import (tërheqje nga sistemi) 14,45% më e lartë se në periudhën e njëjtë 2019, ndërsa eksport (shtyrje në sistem) më e ultë për 13,51% se sa periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

(T5) Humbjet në transmision kanë qenë më të larta për 4,14% krahasuar me vitin 2019. Kanë qenë më të lart, ngase hyrjet në rrjetin e transmetimit (prodhimi dhe hyrjet nga interkoneksioni) kanë qenë për 7.9% më të larta se sa në vitin e kaluar.

AATC-Average Available Transmission Capacity


MATC-Maximum Available Transmission Capacity

AIT=(8760*60*ENS)/TE

ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pafurnizuar

TE-Transmitted energy - ET- Energjia e transmetuar (Energjia që hyn në transmision) është energjia e cila hyn në transmision nga prodhimi i gjeneratorëve (Prodhimi në prag të transmisionit) dhe importeve si rrjedha fizike nga linjat interkonektive (import flow).

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 40 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

4. Operimi i Transmisionit

4.1. Rrjeti transmetues aktual i Kosovës

Rrjeti transmetues i Kosovës është zhvilluar gjatë 60 viteve të fundit në disa faza të ndërtimit, zgjerimit, përforcimit dhe konsolidimit. Rrjeti aktual transmetues (2019) përbëhet prej **1410.5** km gjatësi të linjave, duke përfshirë:

- 279.5 km në nivelin e tensionit 400 kV;
- 238.5 km në nivelin e tensionit 220 kV dhe
- 892.5 km në nivelin e tensionit 110 kV.

Kapaciteti transformues i instaluar i rrjetit horizontal të transmetimit përbëhet prej 16 auto-transformatorësh me kapacitet total 3750 MVA, duke përfshirë:

- 1200 MVA në nivelet e tensionit 400/220 kV (3 ATR)
- 1200 MVA në nivelet e tensionit 400/110 kV (4 ATR)
- 1350 MVA në nivelet e tensionit 220/110 kV (9 ATR)

Kapaciteti transformues i instaluar i rrjetit vertikal të transmetimit përbëhet prej 65 transformatorësh me kapacitet total 2320 MVA, duke përfshirë:

- 160 MVA transformator 220/35/10 kV dhe 220/10 kV (4 TR)
- 340.5 MVA transformator tre-pështjellorë 110/35/10 kV (8 TR-3psh)
- 618 MVA transformator në nivelet e tensionit 110/35 kV (19 TR)
- 1201.5 MVA transformator në nivelet e tensionit 110/10 kV (34 TR)

Në kuadër të transformatorëve të tensionit të lartë të kyçur në rrjetin e transmetimit që nuk menaxhohen nga KOSTT janë:

- 320 MVA 220/35 kV (2 TR- Feronikeli)
- 126 MVA, 110/35/6.3 kV dhe 110/6.3 kV (4 TR-Trepça, aktualisht 3 jashtë punës)
- 40 MVA, 110/6.3 kV (2 TR- Sharr-Cem)
- 20 MVA, 110/6.3 kV (Ujmani- IbërLepenci)

Rrjeti transmetues i Kosovës operon me 37 nënstacione të niveleve të ndryshme të tensionit dhe atë:

- 1 nënstacion 400/220 kV,
- 2 nënstacione 400/110 kV
- 3 nënstacione 220/110 kV
- 2 nënstacione 220/35/10 kV dhe 220/10 kV
- 8 nënstacione 110/35/10 kV
- 6 nënstacione 110/35 kV dhe
- 15 nënstacione 110/10(20) kV

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 41 nga 124</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Në rrjetin e transmetimit janë të kyçura edhe tri nënstatione që menaxhohen nga industria si: Ferronikeli (220/35 kV), Trepça (110/35/6.3 kV) dhe Sharr-Cemi (110/6.3 kV).

Sa i përket kapacitetit interkonektiv rrjeti transmetues i Kosovës karakterizohet si rrjet mjaft mirë i ndërlidhur me rrjetin regional me linjat:

- **400 kV**
 - NS Kosova B - NS Komani (Shqipëri)
 - NS Kosova B - NS Nish (Serbi)
 - NS Peja 3 - NS Ribarevina (Mali i Zi)
 - NS Ferizaj 2 - NS Shkupi 5 (Maqedonia Veriore)
- **220 kV**
 - NS Prizreni 2 B - NS Fierza (Shqipëri)
 - NS Podujeva - NS Krushevc (Serbi)

Në operim janë edhe dy linja 110 kV ndërkufitare me Serbinë ajo NS Vallaq - NS Novi Pazar dhe NS Berivojce - NS Bujanovc.

4.2. Indikatorët Kyç të Performancës për operimin e transmetimit

Nr	Indikator	Niveli i tensionit	Vlera max (2015-2019)	2020	Krahasimi	Caku	Komenti
		kV		Janar Dhjetor	2020/ *Koefficientet max. në vitet (2015-2019)		
T1	Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi	400	0.21	0.00	0.00	<= 1	
		220	0.43	0.00	0.00		
		110	0.83	0.00	0.00		
T2	Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)	400	4.72	0.00	0.00	<1	
		220	8.14	4.89	0.60		
		110	20.19	0.00	0.00		
T3		400	1.60	0.00	0.00	<1	

	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)	220	0.00	0.00	0.00		
		110	0.00	0.00	0.00		
T4	Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi)	400/220(110)	2.10	0.00	0.00	>1	NS Rahoveci shkyçje totale. Intervenim për eliminimin e rrjedhjes së vajit. NS Ferizaj 1-TR3 rënie me nevojë për intervenim si pasojë e dëmtimit të një gypi të vajit.
		220/110	0.00	0.00	0.00		
		110/35/10(20)	16.88	18.00	1.06		
T5	Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë)	400/220(110)	0.00	0.00	0.00	>1	NS Rahoveci shkyçje totale. Intervenim për eliminimin e rrjedhjes së vajit. NS Ferizaj 1-TR3 rënie me nevojë për intervenim si pasojë e dëmtimit të një gypi të vajit.
		220/110	0.00	0.00	0.00		
		110/35/10(20)	9.05	18.16	2.01		
T6	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta)	400/220(110)	0.00	0.00	0.00	>1	NS Rahoveci shkyçje totale. Intervenim për
		220/110	0.00	0.00	0.00		
		110/35/10	10.32	20.33	1.96		

							eliminimin e rrjedhjes së vajit.
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	0.00	0.00	0.00	≤1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110	1.13	0.00	0.00		
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	400	0.00	0.00	0.00	<1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110	0.00	0.00	0.00		
T9	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)	400	0.00	0.00	0.00	< 1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110	0.00	0.00	0.00		
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	400	0.00	0.00	0.00	< 1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110	0.64	0.00	0.00		
T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë)	400	0.00	0.00	0.00	< 1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110	1.14	0.00	0.00		
T12	Koha mesatare shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta)	400	0.00	0.00	0.00	<1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110	0.00	0.00	0.00		

Tabelë. 4-1. Indikatorët Kyç të Performancës për operimin e transmetimit

5. Operimi i tregut

5.1. Madhësia e Tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral. Në këtë Treg mungon konkurrenca si në nivelin e tregut me shumicë po ashtu dhe atë me pakicë. Edhe pse ekzistojnë 8 furnizues të licencuar (KESCO Sh.A., GSA ENERGJI Sh.P.K., HEP-KS Sh.P.K., Future Energy Trading and Exchange Dynamics SH.P.K., Jaha Company SH.P.K., Sharr Cem SH.P.K., KEK SH.A. dhe ENERCO LLC) për furnizim në tregun me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë, aktualisht vetëm KESCO bën furnizimin e të gjithë konsumatorëve të rregulluar dhe atyre të pa rregulluar.

Aktualisht në tregun e energjisë elektrike janë vetëm tre konsumator të parregulluar të cilët janë të kyçur në rrjetin e transmisionit (Ferronikeli i kyçur në nivelin 220kV, kurse SharriCemi dhe Trepça në nivelin 110kV) ndërsa të gjithë konsumatorët tjerë furnizohen me çmime të rregulluara dhe janë pjesë e grupit të konsumatorëve me të drejtë të shërbimit universal. Gradualisht sipas afateve të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRE) edhe konsumatorët e kyçur në nivelin 35kV dhe 10kV duhet të furnizohen me çmim të parregulluar dhe nuk do të jenë konsumatorë me të drejtë të shërbimit universal.

Të dhënat themelore energjetike janë dhënë në vijim:




Fig. 5-1. Të dhënat themelore energjetike




Fig. 5-2. Tregu i rregulluar dhe pa rregulluar

Hapja e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe implementimi i Mekanizmit Balancues

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 45 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

5.2. Hapja e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe implementimi i Mekanizmit Balancues

Më 14 dhjetor 2020 KOSTT ka filluar operimin e pavarur si Zonë Rregulluese dhe si pjesë e Bllokut Rregullues Shqipëri – Kosovë (AK).

Nga kjo ditë ka filluar edhe alokimi i kapaciteteve interkonektive të KOSTT me TSO – fqinjë (përfshirë Zonën Rregulluese të EMS-it) nga Zyra për Alokim të Koordinuar (CAO) në Podgoricë. Alokimi i kapaciteteve interkonektive në emër të KOSTT pritet të sjell zhvillime të reja në tregun (dhe në madhësinë e tregut) e energjisë elektrike në Kosovë.

Duke pasur parasysh rrethanat e reja të krijuara me hapjen e tregut, KOSTT ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për realizimin e udhëzimeve të lëshuara nga ZRrE duke bërë fillimisht krijimin e llogarive të energjisë për palët tregtare të regjistruara në tregun e energjisë elektrike në Kosovë.

Gjithashtu nga aspekti i llogaritjeve energjetike dhe të pagesave nga Operatori i Tregut (OT) menaxhohen këto llogari:

- Llogaria e prodhuesve të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE)
- Llogaria prodhuese e KelKos Energy (HC Lumbardhi I);
- Llogaria prodhuese e KEK-ut;
- Llogaria prodhuese e HC Ujmanit;
- Llogaria e KEDS për humbje në shpërndarje;
- Llogaria e KOSTT për humbje në Rrjetin e Transmetimit;
- Llogaria e KOSTT për humbjet në Sistem (konsumi i veriut) (nga data 5 dhjetor 2020)
- Llogaria e furnizimit për KESCO për konsumatorët e rregulluar (Shërbimi Universal);
- Llogaria e furnizimit për KESCO për konsumatorët e parregulluar
- Llogaria për Fondin e Energjisë së Ripërtëritshme dhe
- Llogaria Balancuese.

Të gjitha llogaritë përmbajnë shënimet për çdo periudë të barazimit përfundimtar (për çdo orë) për energjinë e nominuar (kontraktuar), energjinë e matur dhe obligimet financiare të llogaritura për çdo periudë të barazimit përfundimtar (proces i barazimit energjetik dhe financiar). Në bazë të dhënave nga këto llogari krijohen raporte të cilat përdoren si bazë për faturimin e ndërsjellë mes palëve në treg si dhe për faturimin e pagesës së jobalancëve.

Sipas mekanizimit balancues të gjitha palët të cilat dështojnë të përmbushin obligimet e tyre sipas nominimeve (obligimeve kontraktuale) paguajnë ose paguhen nga llogaria balancuese për energjinë e jobalancit me çmimin e jobalancit.

Pjesëmarrja në tregun e energjisë elektrike në Kosovë është dhënë në vazhdim, ku shihet që Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) dhe KESCO janë palë dominante në treg:




Fig. 5-3. Pjesëmarrja në tregun e energjisë elektrike në Kosovë

KOSTT si Operator i Sistemit Transmetues, bazuar në dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike (Neni 19 dhe 23), është përgjegjës për prokurimin e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit në përputhje me procedurat transparente jo-diskriminuese dhe të bazuar në treg. KOSTT nga 01.04.2017 energjinë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit është duke e blerë në tregun e energjisë elektrike me çmim të de-rregulluar.

Në vazhdim, është dhënë diagrami i pjesëmarrjes së blerjes së humbjeve nga KEK dhe nga Ankandi ditor:




Fig. 5-4. Pjesëmarrja e blerjes së humbjeve nga KEK dhe Ankandi

KOSTT gjatë vitit 2020 ka blerë energji për nevoja të balancimit të sistemit në vlerë të prej 24 GWh.

Energjia balancuese është blerë në Ankand ditor (Intraday) të organizuara nga Operatori i Tregut sipas kërkesës së Operatorit të Sistemit dhe në përputhje me Procedurat për tregtimin e energjisë elektrike.

Përveç energjisë balancuese të blerë në ankand KOSTT nga data 14 dhjetor 2020 ka filluar të implementojë Marrëveshjen për shërbime të rregullimit automatik (aFRR) nga OST dhe Marrëveshjen për shërbime të rregullimit manual (mFRR) nga KESH. Blerja e aFRR dhe mFRR trajtohen si blerje e energjisë balancuese.

Në tabelën dhe diagramin në vazhdim janë paraqitur të dhënat rreth prokurimit të energjisë balancuese gjatë 2020:




Fig. 5-5. Prokurimi i energjisë balancuese 2020





Fig. 5-6. Pjesëmarrja e blerjeve të energjisë nga ana e KOSTT për vitin 2020

5.3. Fondi BRE (Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë elektrike)

Ligji për Energjinë Elektrike LIGJI Nr. 05/L – 085 ndër tjera obligon Operatorin e Tregut për shitblerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të. Në këtë kuadër ZRrE ka miratuar Rregullën për Skemën Mbështetëse, e cila përcakton se Gjeneratorët e BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse ose nën Kornizën e Rregulluar kanë të drejtë të shesin prodhimin e tyre të energjisë elektrike tek OT në KOSTT,

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 49 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

përmes Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë (MBE) të lidhur me KOSTT-in. Energjia elektrike e prodhuar nga gjeneratorët BRE që kanë të lidhur MBE me KOSTT paguhet me tarifë nxitëse (67.47 €/MWh për HC, 85 €/MWh për Burime të Erës dhe 136.40 €/MWh për Burime Fotovoltaike), ndërsa kohëzgjatja e MBE-ve është 10 vite për HC, dhe 12 vite për Burime Fotovoltaike dhe të Erës. Edhe gjatë vitit 2020 KOSTT ka vazhduar procesin e nënshkrimit të MBE-ve me Gjeneratorët BRE, numri i të cilave ka arritur në 31 me kapacitet të instaluar gjithsejtë 246.67 MW. Prej tyre në Operim Komercial janë gjithsejtë 17 Gjeneratorë BRE, me kapacitet të instaluar gjithsejtë 98.51 MW.

Për të mbuluar kostot e prodhimit nga Gjeneratorët BRE, bazuar në dispozitat e Rregullës për Skemën Mbështetëse (Neni 13), është themeluar Fondi për Energjinë e Ripërtëritshme që menaxhohet nga OT. Për operimin e këtij fondi, OT i raporton ZRrE-së në baza tremujore. Nëpërmjet Fondit për Energjinë e Ripërtëritshme, Gjeneratorët e BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse ose nën Kornizën e Rregulluar paguhen për prodhimin e tyre, ndërsa furnizuesit paguajnë për energjinë e ripërtëritshme me çmim referent të miratuar nga ZRRE në proporcion me pjesëmarrjen e konsumit të tyre individual në konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike në Kosovë.

Në tabelën në vijim janë paraqitur energjia e prodhuar nga gjeneratorët BRE të cilët kanë nënshkruar MBE me KOSTT (OT) për blerje të energjisë:

ENERGJIA E MATUR e BRE-ve	Gjithësej
HC Belaja (Kelkos)	12122.16
HC Deçani (Kelkos)	18063.75
HC Brezovica (Matkos Group)	4389.32
HC Albaniku 3 (Hydroline)	8943.11
PSF Onix	655.43
PSF Led Light	129.16
PE Kitka (Air Energy)	91184.18
PSF Birra Peja	4186.45
PSF Frigo Food	4175.83
PSF Eling	625.58
HC Brodi 3 (Eurokos)	9746.03
HC Brodi 2 (Eurokos)	12391.86
HC Restelica 1&2 (Eurokos)	4936.16
HC Orqusha (Renelual Tahiri)	10676.82
HC Lepenci 3 (Hidroenergji)	28159.76
PSF Solar Green Energy	3750.70
HC Lumbardhi 2 (Kelkos)	5559.51
Hc Binqa (Eko Energy)	1270.54
Hc Brodosan (Dilli Energy)	1116.20
HC Albaniku 2 (Hydroline)	4053.88

Tabelë. 5-1. Prodhimi nga BRE pjesëmarrës në Skemën Mbështetëse

6. Pasqyra e performances financiare dhe Rezultatet

6.1. Pasqyra e Pozicionit Financiar 31.12.2020

	2019 (000 Euro)	2020 (000 Euro)
Palujtshmëritë, impiantet dhe pajimet	174,037	159,547
Pasuritë e pa prekshme	557	821
A) Pasuritë jo qarkulluese	174,594	160,368
Stoqet, pjesët rezervë dhe veglat	4,223	4,381
Arkëtueshmëritë	6,674	11,106
Kerkesat tjera	3,534	1,818
Avanset	566	127
Paradhënie për tatim në fitim	49	0
Kërkesat nga jobalancat	697	1,326
Paraja në arkë dhe bilanci bankar	48,457	64,751
Paraja nga granti Qeveritar	0	10,000
B) Pasuritë qarkulluese (kapitali punues)	64,200	93,509
GJITHESEJT AKTIVA A + B	238,794	253,877
C) Kapitali Aksionar	110,434	126,479
Kapitali aksionar	25	25
Kapitali i trashëguar	53,367	53,367
Fitimi i mbajtur	34,742	57,042
Fitimi për periudhë	22,300	16,045
D) Detyrimet Afategjate	113,918	108,601
Të hyrat e shtyera	63,278	56,302
Të hyrat e shtyera nga granti Qeveritar	-	7,673
Obligimet për Kredi	50,640	44,626
E) Detyrimet Afatshkurtëra	14,442	18,797
Pagueshmëritë dhe obligimet tjera	13,745	17,438
Obligimet nga jobalancat	697	1,359
Gjithesejt Detyrimet D + E	128,360	127,398
GJITHESEJT PASIVA C + D + E	238,794	253,877

Tabelë. 6-1. Pasqyra e Pozicionit Financiar

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 51 nga 124</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

6.2. Pasqyra e të ardhurave

Euro (000)

	Realizimi Janar-Dhjetor 2019	Buxheti Janar-Dhjetor 2020	Realizimi Janar-Dhjetor 2020	% realizimit ndaj buxhetit
Të hyrat nga rrjeti 220 /400 kV	521	515	419	81%
Të hyrat nga rrjeti 110 kV	23,168	19,463	19,660	101%
Të hyrat nga sistemi i operimit	13,291	10,909	12,341	113%
Të hyrat nga operatori i tregut	385	322	352	109%
Të hyrat për humbje nga përshtatjet e KEK	2,775	3,329	3,052	92%
Të hyrat për Burimet e Ripërtërishme nga Tarifa dhe fondi	18,289	31,560	25,046	79%
Gjithesejt të hyrat nga tarifat	58,430	66,098	60,870	92%
Të hyrat tjera operative	247	300	303	101%
Të hyrat nga interesi	357	190	544	287%
Të hyrat nga grantet per sherbime(cap.b)	9	0	0	0
Të hyrat nga grantet qeveritare	0		2,327	
Të hyrat nga jobalanca	132	0	242	
Të hyrat nga jobalanca nga importi	420		1,619	
Te hyrat nga tranziti i energjise	999	720	298	41%
Të hyrat e shtyera	6,889	7,014	6,976	99%
Te hyrat nga alokimi I kapaciteteve	0	0	108	
Gjithësejt të hyrat	67,482	74,322	73,288	99%
Shpenzimet operative	28,974	51,515	39,121	74%
1. Mirëmbajtja	684	1,021	753	74%
2. Pagat total	5,283	5,650	5,384	98%
2.1 Pagat e stafit	5,283	5,590	5,353	98%
2.2 Pagat për Bordin e Drejtoreve	0	60	31	52%
3. Shpenzimet tjera operative	1,210	1,613	1,941	73%
4. Humbjet në bartje	4,564	5,150	4,773	93%
5. Humbjet ne veri	-	-	2,327	
6. Humbjet ne 51veri me permbarim	-	-	1,642	
7. Shpenzimet e 51interest per kredi	928	1,608	1,607	100%
8. Shpenzimet e konsulences(cap.b)	9			
9. Shpenzimet e tranzitit	134	720	81	11%
10. Shërbimet ndihmëse	-	3,200	229	7%
11. Shpenzimet per BRE nga Tarifa dhe fondi	15,674	31,560	18,672	59%
12. Shpenzimet nga jobalanca	69	-	93	
13. Shpenzimet nga jobalanca import	420	-	1,619	
14. Shpenzimet e parashikuara per pagesa kundrejt ENTSO-E	-	700	-	
15. Shpenzimeve vjetore te parashikuara nga OST per pagesa kundrejt ENTSO-E	-	230	-	
16. Sherbimi per RSC	-	63	-	
Fitimi para amortizimit	38,508	22,807	34,167	
Amortizimi	14,744	17,000	16,257	
Gjithësejt shpenzimet (operative+amortizimi)	43,718	68,515	55,378	
Fitimi para tatimit	23,764	5,807	17,910	
Tatimi në fitim	1,463	0	1,865	
Neto Fitimi / Humbja	22,301	5,807	16,045	

Tabelë. 6-2. Pasqyra e të Ardhurave

6.3. Pasqyra e ndryshimeve në kapital 31.12.2020

	Kapitali Aksionar	Rezervat e Transferit	Fitimet e mbajtura	Gjithësejt
Gjendja më 1 janar 2019	25	53,367	36,489	89,881
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	22,301	22,301
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	22,301	22,301
Gjendja më 31 dhjetor 2019	25	53,367	58,790	112,182
Korrigjim			(1,747)	(1,747)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	25	53,367	57,043	110,435
Gjendja më 1 janar 2020	25	53,367	57,043	110,435
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	16,045	16,045
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	16,045	16,045
Gjendja më 31 dhjetor 2020	25	53,367	73,087	126,479

Tabelë. 6-3. Pasqyra e ndryshimeve në kapital

6.4. Pasqyra e Rrjedhës së Parasë 2020

(000 Euro)

Rrjedha e parasë nga Aktivitetet Operative


Fitimi/Humbja para Tatimit	17,910
<i>Përshtatjet për:</i>	
Amortizimi/Zhvlerësimi	16,257
Të hyrat nga interesi	(544)
Shpenzimet e interesit	1,607
Hedhja e pasurive fikse	61
Të hyrat e shtyra	(9,302)
Rrjedha operative e parasë para lëvizjeve në kapitalin punues	25,988
Rritje/Zvogëlim në stoqe	(159)
Rritje/Zvogëlim në llogari të arkëtueshme	(4,431)
Rritje/Zvogëlim në kërkesa tjera	1,417
Rritje/Zvogëlim në avanse	127
Rritje/Zvogëlim në llogari të pagueshme dhe obligime tjera	3,809
Tatimi I paguar	(1,257)
Gjenerimi i parasë nga Aktivitetet Operative	25,495
Rrjedha e parase nga Aktivitetet Investive	
Interesi i pranuar	544
Blerja e aseteve të reja	(2,125)
Investimi në depozita	(26,000)
Paraja neto nga Aktivitetet Investive	(27,580)
Rrjedha e parasë nga Aktivitetet Financuese	
Interesi i paguar	(1,607)
Huatë e pranuar	
Huatë e paguara	(6,014)
Grantet e pranuar	10,000
Neto paraja e gjeneruar nga Aktivitetet Financuese	2,379
Rritja neto e parasë dhe ekuivalenteve të parasë	294
Paraja dhe ekuivalentet e parase me 01.01.2020	27,657
Paraja dhe ekuivalentet e parase me 31.12.2020	27,951

Tabelë. 6-4. Paqyra e Rrjedhës së Parasë

6.5. Analiza e IKP-ve financiare

Treguesit	I-XII 2019	I-XII 2020	Shpjegimet
T1. Fitimi operativ marginal = Fitimi neto /gjithsejtë të hyrat	0.33	0.22	<p>Qëllimi është që të jetë mbi zero. Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionet vijuese.</p> <p>Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj.</p> <p>Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë.</p>
T2. Treguesi i likuiditetit = pasuria qarkulluese/detyrimet qarkulluese	5.54	4.91	<p>Përcakton aftësinë e kompanisë për të paguar detyrimet e saj afat shkurta. Sa më e lartë është vlera e këtij treguesi, aq më e lartë është siguria që kompania posedon mjete për të mbuluar borxhet afatshkurta.</p> <p>Treguesi duhet të jetë më i madh se 1.</p>
T3. Treguesi i qarkullimit të kërkesave=kërkesat *365 ditë/të hyrat	40.21	63.35	<p>Ky tregues është i matshëm në baza vjetore Caku: ≤ 90 ditë</p>
T4. Giring = kreditë afatgjate jashtë vendit/kapitali*100	44.55	34.81	<p>Ky tregues tregon raportin mes borxhit total afatgjatë dhe kapitalit. Është një tregues për të matë levën financiare, duke demonstruar shkallën në të cilën aktivitetet e një kompanie janë financuar nga fondet e kompanisë kundrejt fondeve të kreditorit.</p> <p>Caku: < 60%</p>

Tabelë. 6-5. Analiza e IKP-ve financiare

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 55 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

6.6. Progresi me planin e Biznesit


KOSTT sh. a, është ndërmarrje publike, që zë një vend të rëndësishëm në sektorin e energjisë në Kosovë dhe e cila vepron si Operator i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës. KOSTT drejtohet me ligjin korporativ të emërtuar si Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Në përputhje me Ligjin e Energjisë Elektrike dhe licencat e lëshuara, KOSTT është përgjegjës për:

- Transmetimin e energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara në licencë, në mënyrë objektive, transparente dhe jo diskriminuese në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke ruajtur sigurinë e sistemit elektroenergetik sipas këtij ligji;
- Operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemit të Transmetimit dhe interkonektorëve të tij me sisteme tjera, në mënyrë që të ofrojë siguri afatgjatë të operimit të sistemit dhe siguri në furnizim me energji elektrike, duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit;
- Administrimin, operimin dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese;
- Menaxhimin e procesit të Barazimit Përfundimtar të Palëve në treg;
- Operimin e Sistemit të Transmetimit në pajtueshmëri me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe të gjitha kodet dhe rregullat tjera të zbatueshme, në mënyrë që të arrijë sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe shfrytëzimin ekonomik të rrjetit të transmetimit;
- Planifikimin e operimit të sistemit elektroenergetik, në bashkëpunim me Operatorin e Tregut dhe operatorët e sistemeve të transmetimi të shteteve fqinje, si dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe shfrytëzuesve të Rrjetit;
- Balancimin e sistemit të energjisë elektrike në harmoni me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Rregullat e Tregut;
- Sigurimin e besueshmërisë dhe disponueshmërisë së sistemit të transmetimit, në mënyrë që të mundësojë furnizim të sigurt me energji elektrike, duke mbajtur mjaftueshmërinë e kapaciteteve të transmetimit;
- Mundësimin përdoruesve në qasje dhe shfrytëzim të rrjetit të transmetimit sipas parimeve transparente dhe jo diskriminuese;
- Ofrimin e informatave operatorëve të sistemeve fqinje, me të cilët është i ndërlidhur sistemi i transmetimit, me qëllim të arritjes së operimit të sigurt dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërveprimin e sistemeve të interkonektuara; etj.
- Përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës SCADA/EMS për realizimin e funksioneve të operimit të sistemit të transmetimit;
- Menaxhimin e fondit të BRE
- Menaxhimin e procesit të ndërrimit të furnizuesit.

Përveç përgjegjësiave primare të cekura më lartë, KOSTT ka edhe përgjegjësitë sekondare, që janë:

- që të ofrojë shërbimet e shfrytëzimit të fibrave optik (komercializimi i fibrave optik) në infrastrukturën e telekomunikacionit në të tërë vendin, si dhe vendet e rajonit në bashkëpunim me OST-të përmes rrjetit transmetues të KOSTT dhe linjave interkonektive. Në këtë drejtim, përgjegjësitë e KOSTT-it përcaktohen nga Ligji për Telekomunikacion dhe Ligji për Komunikime Elektronike si dhe Autorizimi/Licenca e lëshuar nga ARKEP-i.
- Dhënia e shërbimeve të konsulencës në nivel lokal dhe ndërkombëtar;
- ofrimi i shërbimeve profesionale për palët e treta (kyçja e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë në rrjetin e transmetimit, si dhe ndërtimet e objekteve afër rrjetit të transmetimit).

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 56 nga 124</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Misioni

Misioni i KOSTT-it është:

- Operimi i sigurt dhe i besueshëm i Sistemit Të transmetimit, duke garantuar sigurinë e furnizimit, si dhe operimin efikas të tregut të energjisë elektrike në bazën e transparencës dhe jo diskriminimit, në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës.

Vizioni

“Të jetë kompani kredibile, që garanton transmetimin e sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike, e përgjegjshme në kuptimin social dhe mjedisor, e integruar në rrjetet dhe institucionet evropiane të transmetimit të energjisë elektrike “.

Vlerat themelore

Siguria dhe Besueshmëria: transmetim të sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike për të gjitha palët e kyçura në Sistemin e Transmetimit të Kosovës, në përmbushje të objektivës për sigurinë e furnizimit cilësor dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Përgjegjësia: Në përmbushjen e obligimeve si kompani publike KOSTT përdor resurset në mënyrë sa më optimale dhe është e përkushtuar në mirëmbajtjen, zhvillimin dhe avancimin e vazhdueshëm të Sistemit të Transmetimit, duke krijuar vlerë për aksionarin. KOSTT është e përkushtuar dhe e përgjegjshme ndaj palëve, punonjësve, komunitetit, mjedisit dhe shoqërisë në përgjithësi.

Bashkëpunimi: KOSTT-i vazhdimisht favorizon dhe kultivon bashkëpunimin dhe punën ekipore, që shpie në kryerjen e detyrave drejt arritjeve të përbashkëta, për të përmbushur misionin e saj dhe zhvillimin afatgjatë të kompanisë.


Transparenca: KOSTT qeveriset mbi bazën e transparencës dhe llogaridhënies. KOSTT ofron qasje jo-diskriminuese për të gjitha palët e kyçura në Rrjetin e transmetimit, zbaton me transparencë procedurat si dhe ofron informacione të hapura për të gjitha palët e tregut të energjisë elektrike, palët e interesit dhe opinionit në përgjithësi.

Dija: Përmes përvetësimit të vazhdueshëm të njohurive, dhe përvojës shumëvjeçare, KOSTT ndërton profesionalizmin e tij, përmirëson performancën dhe mbetet e përkushtuar në gjetjen e zgjidhjeve më të mira për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë.

Moto e KOSTT

Energjia jonë, zëri i së ardhmes!

Me qëllim që të realizojë synimet e përcaktuara, KOSTT ka vendosur objektivat strategjike, të cilat para së gjithash kanë të bëjnë me sigurimin se KOSTT-i është një organizatë efektive, e aftë për të përballuar sfidat me të cilat do të përballlet në të ardhmen.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 57 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	


Objektivat e vendosura të KOSTT janë:

1. Planifikimi, zhvillimi dhe ndërtimi efektiv i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
2. Mirëmbajtja dhe operimi i sigurtë dhe i besueshëm i sistemit të transmetimit;
3. Krijimi i kushteve për një treg të liberalizuar dhe të integruar të energjisë elektrike
4. Krijimi i tregut të organizuar një ditë para dhe tregut balancues të energjisë elektrike;
5. Sigurimi i stabilitetit financiar të kompanisë;
6. Operimi si LFC zonë në kuadër të AK LFC Bllokut
7. Anëtarësimi në ENTSO-E dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë;
8. Avancimi i partneriteti me palët e interesit;
9. Të jetë punëdhënës atraktiv, duke siguruar barazinë gjinore dhe që investon në zhvillimin profesional të punonjësve, të talenteve dhe në avancimin e dijes;
10. Të jetë kompani e përgjegjshme ndaj komunitetit, në aspektin social dhe mjedisor;
11. Të krijojë një ambient të sigurtë dhe të shëndetshëm pune;
12. Menaxhimi i cilësisë dhe avancimi i ndërmarrjes sipas standardeve ISO;
13. Rritja e të hyrave nga shërbimet për shfrytëzim të infrastrukturës së sistemit të telekomit dhe nga shërbimet tjera sekondare;
14. Akomodimi i kyçjeve të reja në rrjetin e transmetimit;
15. Kontribuoj në mbarëvajtjen e punës për Integrimin e Tregut të Energjisë Elektrike (EMI).

Objektivat e lartcekura do të shërbejnë për analizimin e të arriturave të KOSTT gjatë vitit 2020, respektivisht, për implementimin e Plani të Biznesit për vitin referues.

Gjatë vitit 2020, janë realizuar 96% të aktiviteteve të ekipeve të mirëmbajtjes së linjave dhe 93% të mirëmbajtjes së Qarqeve primare, 100% Qarqet sekondare dhe 97% Mbrojtjet rele. Aktivitetet kryesore të cilat janë përfshi në planin e mirëmbajtjes janë: kontrollimi i linjave dhe nënstacioneve, remontet e linjave dhe transformatorëve, shqyrtimi i rregullt transformatorëve dhe i fushave, termovizioni, shpërndarja e gazrave (DGA), shqyrtimet e mbrojtjeve rele, zëvendësimi i pjesëve dhe pajisjeve të domosdoshme në sistem, si dhe aktiviteteve të planifikuara të mirëmbajtjes si pjesë e zhvillimit të projekteve dhe komisionimit të tyre.

Përveç kësaj janë zhvilluar edhe aktivitete tjera preventive si: realizimi i intervenimeve dhe evitimi i prishjeve, analizimi i prishjeve, Analiza e rënive dhe Operimeve, specifikimet teknike, pjesëmarrja në komisione të ndryshme për vlerësimin e ofertave, pjesëmarrja në komisione të ndryshme për pranim teknik, pjesëmarrja në implementimin e projekteve të ndryshme në Kostt, Popullimi me shënimeve e aplikacionit QGIS për LP etj. Të gjitha këto aktivitete kanë ndikuar në ngritjen e performancës së operimit të transmisionit, kjo ka kërkuar një menaxhim dhe optimizim maksimum të ekipeve në teren.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 58 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

KOSTT do të vazhdojë edhe më ngritjen profesionale të stafit të mirëmbajtjes për teknologjinë e re në nënstacione dhe situatën e re të krijuar në linja, pas investimeve në linja të dyfishta si dhe kompletimin më tutje të pajisjeve të nevojshme.

Duke konsideruar perspektivën për angazhim në projekte të reja (biznese tjera jo të rregulluara), mundësia më evidente për KOSTT-in tani është dhënia e shërbimeve nga lëmi i telekomunikacionit përkatësisht, paraqitja në treg e kapaciteteve tepriçë të fijeve optike. Këto kapacitete telekomunikuese janë ndërtuar me qëllim të zhvillimit të sistemit të kontrollit dhe monitorimit të operimit të sistemit të transmetimit, andaj detyrë kryesore është (dhe do të jetë në të ardhmen): Sigurimi i mbështetjes telekomunikuese për biznesin kryesor të KOSTT-it.

Gjatë vitit 2020 KOSTT vazhdoi me nënshkrimin e marrëveshjeve me kompani vendore për shfrytëzimin e rrjetës së fibrave optik (dark fibre). Që nga viti 2004, paralel me zhvillimin e Sistemit Transmetues të energjisë elektrike, KOSTT po ashtu ka ndërtuar dhe zhvilluar rrjetin e ri telekomunikues të bazuar në fibra optik OPGW (Optical Power Ground Wire), me gjatësi prej 1210 km të vendosur nëpër largpërçues të tensionit të lartë.

Në përputhje me nenin 5.2 dhe 5.3 të Rregullores për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike) dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, gjatë vitit 2020, KOSTT sh.a nënshkroi një marrëveshje të re për ofrimin e shfrytëzimit me qira të rrjetës së fibrave optik (dark fibër/të pa-ndriçuar), ndërsa marrëveshjet tjera të nënshkruara janë vazhdim i marrëveshjeve të deri tanishme.. Shërbimi i Fibrave të pa-ndriçuar u mundëson operatorëve të lidhin teknologjitë e tyre përkatëse të transmetimit optik me fibrat e pashfrytëzuara të rrjetit të KOSTT-it, për të ofruar shërbimet e veta të transmetimit në tërë territorin e Kosovës.

Duke hyrë në tregun e telekomunikacionit të Kosovës, KOSTT:


- Zgjerohet në aktivitete të reja telekomunikuese, përveç aktiviteteve ekzistuese.
- Është më i përgatitur për të përballuar me sfidat e tregut të Kosovës: tani dhe në të ardhmen.
- Realizon fitim shtesë.
- Arrin një shkallë më të lartë të efektivitetit të biznesit të KOSTT-it.
- Mund të bashkëpunojë me operatorët fqinj të infrastrukturës së telekomunikacionit (në bazë të marrëveshjeve rajonale).
- Mbanë një licencë të Operimit të Shërbimeve të Infrastrukturës së Telekomunikacionit.
- Kontribuon në zhvillimin e TIK-ut në Kosovë.

Deri më tani janë komercializuar 26 linqe optike me 1 (një), 2 (dy) ose 13 (tre) fije optike, me gjatësi prej: 640.67 km.

Projekti Autostrada Digjital Ballkanike/"Balkans Digital Highway", i mbështetur nga Banka Botërore (BB), është duke vazhduar me zhvillimet me këshillime për të adresuar kërkesën për shfrytëzimin e kapaciteteve të tepërta në rrjetet ekzistuese me fije optike si një iniciative rajonale për bashkë shfrytëzimin e infrastrukturës telekomunikuese.

Në mbështetje të plotë nga BB është marrë edhe iniciativa për aplikim në WBIF ("Western Balkans Investment Framework") për një grant për Asistencë Teknike për realizimin e studimit të fizibilitetit, dizajnimin e projektit dhe analizën cost-benefit për projektin "Balkans Digital Highway", i cili ka karakter lokal dhe rajonal sepse në të po marrin pjesë katër vende nga Ballkani Perëndimor: Kosova, Shqipëria, Maqedonia Veriore dhe Mali i Zi.

Në janar 2020, KOSTT ka pranuar njoftimin nga BB se aplikimi për grant është aprovuar dhe se është vlerësuar lartë iniciativa e dorëzimit të aplikimit për këtë projekt. Në dhjetor është shqyrtuar për miratim final aplikimi në WBIF për grant për asistencë teknike për projektin "Balkans Digital Highway".

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 59 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Nga aspekti i sistemeve SCADA/RTU janë bërë një varg ndërhyrjesh në riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të sistemeve të SCADA-ve ekzistuese ekzistuese në nënstatione. Është bërë edhe testimi periodik i funksionalitetit të Qendrës Emergjente Dispeçerike, i cili ka rezultuar me sukses.

Janë bërë edhe shumë veprime të tjera të cilat kanë ndikuar në ngritjen e besueshmërisë së sistemit, në shfrytëzimin më të mirë të aplikacioneve të SCADA/EMS, si dhe në ngritjen e saktësisë së të dhënave në SCADA/EMS, si:

- Korrigjimi i parametrave të rrjetit me qëllim të akordimit të State Estimatorit me SCADA/EMS dhe mundësimin të analizave kontingjente,
- Freskimi i topologjisë të rrjetit të transmetimit të observuar në nivel rajonal,
- Adaptimi i modulit “Outage Schedule” për përcjelljen e shkyçjeve në formë elektronike;
- Testimi dhe implementimi i sistemit të AGC KOSTT – OST me QDN të OST;

Edhe gjatë vitit 2020 KOSTT ka vazhduar me angazhimin për rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike duke realizuar projekte të aprovuara në planin investiv si dhe duke përcjellë zhvillimet për sigurinë kibernetike.

Gjatë vitit 2020 KOSTT ka punuar në mënyrë intensive në drejtim të implementimit të Politikave për Sigurinë e Informacionit dhe Komunikimit, dokument i aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT, me qëllim të ngritjes së sigurisë dhe ruajtjes së integritetit të të dhënave. Lidhur me këtë duhet të theksojmë se KOSTT ka investuar në instalim të softuerëve të cilët ndihmojnë në ngritjen e nivelit për Sigurinë Kibernetike.

Gjithashtu, gjatë vitit 2020 është punuar në përgatitjet e projekteve për implementim gjatë vitit 2020/2021, duke synuar që të krijohet një infrastrukturë e mirë si nga ana harduerike, ashtu edhe ajo softuerike, gjegjësisht që përmes zhvillimeve të planifikuara të realizohen objektivat e përcaktuara të KOSTT për Sigurinë Kibernetike.


Ashtu si edhe vitet e mëparshme, me qëllim të arritjes së objektivave të saj KOSTT ka punuar në krijimin e kushteve sa më të mira të punës për të gjithë punëtorët e saj si në rregullimin e hapësirave të punës ashtu edhe në krijimin e kushteve tjera më të mira për punë, duke vazhduar me renovimin e nënstationeve duke u bazuar në efikasitetin e energjisë, largimin e materialeve të dëmshme si dhe mirëmbajtjen e rregull të tyre. Gjatë vitit 2020 është rinovuar ndërtesa në nënstationin NS Prishtina 1 si dhe janë përgatitur specifikimet për renovim të disa nënstationeve si NS Prishtina 3, NS Gjakova 2 dhe NS Podujeva. Gjithashtu janë realizuar shumë projekte që kanë të bëjnë me infrastrukturë ndërtimore të Nënstationeve të KOSTT.

Siguria fizike në KOSTT, e cila nënkupton mbrojtjen e të gjitha asetëve të kompanisë KOSTT nga kërcënimet me vjedhje apo dëmtime, gjatë vitit 2019 edhe përkundër shumë rasteve të tentim vjedhjes dhe vjedhjeve, është arritur që asetet vitale të mbahen të pacenuara, dhe si rezultat i kësaj nuk është rrezikuar për asnjë moment funksionimi i punës nëpër objekte dhe nënstatione të KOSTT-it, të cilat do të mund të ndikonin në vazhdimësinë e punës.

Janë ndërmarrë një sërë veprimesh në objektet më të atakuara, të cilat kanë pasur impakt pozitiv në sigurinë fizike, si: lëvizja strategjike e rojeve, shtimi i numrit të pikë-rojeve, rregullimi i ndriçimit, intensifikimi i inspektimeve etj.

Nga aspekti i sigurisë fizike është kontraktuar punimi i rrethojave në NS Theranda dhe SSH Drenasi dhe ka filluar realizimi i tij.

Gjithashtu është përgatitur specifikimi dhe prokuruar projekti Punimi i depos së mbyllur në Obiliq” ku deponohen të gjitha pjesët rezervë të nevojshme për intervenimet e rregullta si dhe ato emergjente e të gjitha NS dhe linjave të cilat mirëmbahen nga KOSTT.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 60 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Një nga objektivat strategjike të KOSTT është edhe përkujdesi për shëndetin e punëtorëve, i cili është realizuar me projektin e sigurimit shëndetësor suplementar për të gjithë punëtorët edhe gjatë vitit 2020, meqenëse Ligji për sigurimet shëndetësor ende nuk është implementuar. Kjo ka ndikuar në mbajtjen e shëndetit të mirë të punëtorëve, në motivimin e punëtorëve për punë dhe arritjen e objektivës për të qenë punëdhënës atraktiv si dhe në ngritjen e kualitetit të punës dhe performancës së kompanisë në përgjithësi.

Në kuadër të kujdesit shëndetësor si kërkesë obligative ligjore me qëllim të përcjelljes permanente të gjendjes shëndetësore të punëtorëve, hyjnë edhe kontrollet sistematike mjekësore, të cilat për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia e shkaktuar nga korona virusi Covid-19, kanë devijuar nga plani për vitin 2020, por duke arritur që të realizohen kontrollet sistematike mjekësore kryesisht për vendet e punës në kushte specifike të punës.

Me qëllim të sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve, KOSTT i kushton kujdes të veçantë, sigurisë së aseteve dhe menaxhimit mjedisor duke përmbytur: furnizimin me pajisje mbrojtëse; informimin dhe përkrahjen gjatë implementimit të dokumentacionit për zbatimin e procedurave për punë të sigurt gjatë mirëmbajtjes për linja, nënstacione dhe për kontraktues; inspektimin/monitorimin në teren të objekteve, aseteve, ekipeve të mirëmbajtjes dhe procesin gjatë realizimit të projekteve; largimin e materialeve të rrezikshme për shëndetin nga objektet ekzistuese; realizimin e matjeve të dëmtesve fiziko-kimik, kushteve mikroklimatike dhe intensitetit të fushave elektromagnetike në vendin e punës; angazhimin mbi zhvillimin e projektit për siguri dhe mjedis dhe sipas planit zhvillimor; zhvillimin dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit për menaxhimin e sistemit të sigurisë dhe shëndeti në punë si dhe sistemin e menaxhimit të mjedisit konform rregullativës ligjore dhe kërkesave nga certifikimi me standardet ISO 14001 dhe OHSAS 18001; zhvillimi dhe mbajtja e programeve trajnuese për punëtorë; bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale etj.


KOSTT edhe gjatë vitit 2020, si edhe deri më tani, ka ofruar mbështetje për kryerjen e praktikës profesionale për studentë. Për shkak të pandemisë nga Covid-19 dhe organizimit online të procesit mësimor në universitete, është ndikuar edhe procesi i praktikës profesionale.

Pjesërisht është arritur zbatimi i marrëveshjeve për praktikë profesionale mes KOSTT - “Kosovo CSR Network”, KOSTT- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) dhe KOSTT-Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë (UBT) . Në këtë drejtim KOSTT ka shpreh gatishmërinë për të kontribuar në zhvillimin dhe përkrahjen e studentëve dhe profesionistëve të rinj në fushën e energjisë elektrike dhe në bashkëpunim me partnerët, do ta bëjë edhe në të ardhmen.

Me qëllim të përkrahjes financiare për studentët në sektorin e energjisë elektrike, KOSTT gjatë viti 2020 ka zhvilluar konkursin publik për ndarje të 10 bursave për studentë të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike për vitin akademik 2020/2021. Të gjitha procedurat e konkursit dhe përzgjedhjes janë zhvilluar konform Politikës për ndarjen e bursave dhe pas përfundimit të procesit, 10 studentë-bursistë kanë filluar të marrin bursat nga muaji tetor 2020.

Nga perspektiva e Planit të Biznesit, aspekti më i rëndësishëm rregullativ është përcaktimi i të hyrave maksimale të lejuara dhe tarifave nga ana e ZRrE-së. Në bazë të Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për të Hyrat e OST/OT-së), KOSTT ka përgatitur dhe dorëzuar në ZRrE Aplikacionin për Përshtatjet e Rregullta Vjetore për vitin 2019 dorëzuar, sipas shkresës së iniciuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, të datës 9 Dhjetor 2019 ku ka hapur procesin e Azhurnimeve Vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe përcaktimin e Tarifave të Transmetimit për vitin 2020.

Në vitin 2018 ZRrE ka kryer procesin e shqyrtimit periodik për periudhën e dytë Rregullative (PRR2) 2018-2022 për KOSTT. Në pajtim me Rregullat e të Hyrave këto parashikime duhen azhurnuar për të marrë parasysh dallimet që

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 61 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

ndodhin ndërmjet vlerave të parashikuara ndaj atyre të realizuara. Këto përshtatje barten në vitin vijues, apo dallimet e vitit t-1 barten në vitin t në kuadër të procesit relevant tarivor.

Po ashtu sipas afateve të përcaktuara nga ZRrE janë përgatitur dhe janë dorëzuar dokumentet në ZRrE sipas orarit indikativ dhe kërkesave të ZRrE-së:

- Modeli i ZRrE për Përshtatjet Vjetore për vitin 2020,
- Lista e Projekteve Kapitale të Realizuara 2020 dhe planifikimi për vitin 2021 me kërkesat për projekte të reja.

Në aspektin e tarifave vend të veçantë ka dhe Modeli për Planifikim Financiar Afatgjatë. Gjatë vitit 2020 është populluar Modeli Financiar me të dhënat e fundit të kompanisë duke na dhënë kështu pasqyra shumë të rëndësishme mbi kompaninë dhe planifikimin për vitet në vijim. Ndryshimet e bëra në Model tek përfshirja e Fondit për Burime të Ripërtëritshme si dhe Kalkulimin e Tarifës për Fondin për Burime të Ripërtëritshme, kanë ndihmuar në prezantimin më të mirë në pasqyrave financiare më të gjeneruara nga Modeli.


Gjatë vitit 2020 është shfrytëzuar sistemi elektronik i Arkivit krahas arkivimit fizik të dokumenteve duke mundësuar efikasitetin më të lartë në punë, dhe duke mundësuar shfrytëzimin e sistemit edhe nga ana e Menaxhmentit. Në harmoni me kërkesat ligjore është rregulluar Arkiva qendrore duke e përfshirë arkivin aktiv, ndërkaq arkiva pasive është rregulluar dhe i gjithë dokumentacioni është vendosur sipas standardeve të kërkuara dhe në harmoni me politikën dhe procedurën për arkiv.

KOSTT mirëmban dhe punon në avancimin e mëtutjeshëm të imazhit të kompanisë, i cili tashmë është krijuar, zhvilluar dhe konsoliduar duke përdorur një Strategji të Komunikimit të bazuar në një kombinim efektiv të mjeteve të komunikimit. KOSTT nëpërmes Zyrës për Komunikim dhe Relacione me Publikun (ZKRP) planifikon dhe zbaton rrjedhat e komunikimit dhe ndërmerr aktivitete të vazhdueshme në mbështetje të objektivave strategjike të kompanisë. KOSTT beson që përgjegjësia dhe transparencja ndaj aksionarit dhe palëve të tjera të interesit janë ndër parimet bazë në përmbushjen e mandatit si institucion publik derisa reputacioni është një nga asetet e rëndësishme strategjike i cili ka ndikim në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e besimit të palëve interesit.

Përkundër situatës globale të krijuar nga pandemia me COVID-19, sipas mandatit të përcaktuar, gjatë vitit 2020 ZKRP ka zbatuar strategji proaktive e cila ka ndikuar në imazhin e kompanisë tek palët e interesit. Në përputhje me trendet botërore në industrinë e marrëdhënieve me publikun, KOSTT ka rishikuar dhe përshtatur Strategjinë e Komunikimit për të qenë në funksion të objektivave strategjike të kompanisë, janë implementuar aktivitete të vazhdueshme në shërbim të informimit të opinionit publik në lidhje me aktivitetet dhe veprimtarinë e KOSTT, vizibilitetit të kompanisë, janë realizuar publikime si dhe janë organizuar ngjarje për të prezantuar të arriturat e kompanisë gjatë vitit 2020.


Në mbështetje të objektivës strategjike nr.8 për avancimin e partneritetit me palët e interesit, ndër të tjera në vitin 2020 KOSTT është anëtarësuar në dy institucione të rëndësishme të biznesit të cilat gëzojnë reputacion pozitiv profesional: Odën Ekonomike të Kosovës dhe Odën Amerikane në Kosovë (AMCHAM). Derisa në mbështetje të objektivës strategjike nr.9, ZKRP gjithashtu ka zhvilluar disa projekte me qëllim të fuqizimit të gruas si dhe promovimit të të drejtave të barabarta gjinore duke e bërë KOSTT pjesë të kampanjave globale #EachForEqual dhe #INWED20 për të dhënë kontributin e saj për ndryshim pozitiv dhe duke bërë thirrje për avancim të agjendës për barazi gjinore në sektorin e energjisë. Në anën tjetër gjithashtu janë zhvilluar projekte në funksion të avancimit të komunikimit të brendshëm dhe promovimit të kapitalit njerëzor të kompanisë #NeJemKOSTT / #WeAreKOSTT.

Industria e komunikimit ka evoluar shumë në vitet e fundit sidomos me paraqitjen e mediave sociale, që janë bërë një mjet shumë dinamik dhe një nga kanalet kyçe dhe më të shpejta për të plasuar informacionin, dhe në këtë drejtim në vitin 2020 KOSTT ka filluar prezencën në mediat sociale dhe ka menaxhuar me sukses komunikimin me opinionin

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 62 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

publik përmes këtij kanali. Tutje, përmes promovimit përmes mediave sociale të punës e cila realizohet në terren ka ndikuar dukshëm në motivimin dhe ngritjen e moralit të punonjësve të kompanisë. KOSTT në vazhdimësi zbaton politikë të integruar të komunikimit me qëllim të ruajtjes së cilësisë, qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë së informative derisa në përputhje me qasjen transparente si një nga vlerat themelore të kompanisë, KOSTT zbaton strategji proaktive në informimin e palëve të interesit dhe opinionit në përgjithësi në lidhje me zhvillimet në kompani. Gjatë vitit 2020, si rezultat i zhvillimeve madhore në KOSTT edhe interesimi i mediave dhe palëve të tjera të interesit karshi zhvillimeve ka qenë i theksuar, dhe në këtë drejtim në përputhje me qasjen transparente janë ofruar informacione në vazhdimësi.

Në anën tjetër, në vazhdimësi të përkushtimit në mbështetje të objektivës strategjike 10, përmes ZKRP KOSTT ka vazhduar me aktivitete të përgjegjësive shoqërore korporative (CSR) në kuadër të “Kosovo CSR Network” si rrjeti i parë i bizneseve i themeluar me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të përgjithshëm ekonomik duke zbatuar praktikat më të mira të CSR në shoqëri. Falë përkushtimit konsistent në avancimin e parimeve të CSR, në vitin 2020 KOSTT gjithashtu ka arritur që të bëhet pjesë e Bordit udhëheqës të organizatës Kosovo CSR Network. Në mbështetje të përkushtimit të vazhdueshëm në objektivën strategjike nr.10 të KOSTT për implementimin e parimeve të CSR si për nga aspekti i veprimtarisë që ushtron gjithashtu janë realizuar edhe përkrahje filantropike të kohëpaskohshme për komunitetin duke bërë përpjekje për të ndikuar në zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenien e shoqërisë.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 63 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

7. Realizimi I Projekteve Kryesore Kapitale Gjatë Vitit 2020

Në përputhje me Planin e Biznesit 2020 dhe Planin Zhvillimor të Transmisionit 2018-2022, investimet e planifikuara kryesisht kanë qenë në infrastrukturë për transmetimin e energjisë elektrike dhe janë përqendruar në:

- Përforcimet në rrjetin e transmisionit;
- Përkrahjet e ngarkesës/nënstacionet e reja 110/10(20)kV ;
- Ri-vitalizimi i rrjetit të transmisionit;
- Projektet përkrahëse të operimit të sistemit të transmisionit (menaxhim, monitorim, matje dhe kontroll);
- Në përkrahje të energjisë së ripërtërishme
- Përkrahja dhe menaxhimi i aplikacioneve dhe marrëveshjeve për kyçje për gjeneruesit e rinj në rrjetin e transmisionit.

Viti 2020 karakterizohet si vit i vazhdimësisë së projekteve të filluara në vitet paraprake, të financuara nga BERZH përmes kredisë dhe buxhetit vetanak të KOSTT-it. KOSTT gjatë vitit 2020, ka qenë i fokusuar në plotësimin e obligimeve dhe detyrave në lidhje me përfundimin e implementimit të projekteve me kohë dhe buxhet të planifikuar, konform kushteve të kontratës. Pra, këtu kemi të bëjmë me projektet në zhvillim e ato që kanë qenë në afat garantues.

1. *Projekti i përfunduar gjatë vitit 2020 dhe është në afat garantues :*

- **Linja 110 kV e njëfishtë ajrore NS Rahoveci – NS Theranda,**

2. *Projekti i cili nuk ka përfunduar për shkak të çështjeve pronësoro juridike janë shkaktuar vonesa në implementimin dhe përfundimin e projektit shtyhet deri në Prill 2021*

- **Linja Ajrore/Kabllore 110kV NS. Fushë Kosova**


3. *Projektet për të cilat ka përfunduar edhe afati garantues dhe janë projekte të përmbyllura edhe financiarisht :*

LOT 1 –Nënstacionet GIS në vazhdimësi,

- 110/10(20) kV – NS Prishtina 6 Dardania dhe 110 kV HIS në NS Prishtina 4 ;
- 110/10(20) kV – NS Mitrovica 2- Ilirida ;
- 220/10(20) kV – NS Drenasi 2

LOT 2 – Transformatorët e fuqisë: 40MVA 2x40 MVA :


- NS Prishtina 6 (Dardania) , 2x40 MVA në NS Mitrovica 2 (Ilirida) dhe 2x40 MVA në NS Drenasi 2 ,;

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 64 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>


- LOT 3 – Linjat transmetuese:
 - Linja 110 kV e dyfishtë kabllorike, NS Pristina 6 – NS Prishtina 4
 - Linja 110 kV e dyfishtë kabllorike NS Mitrovica2 (ilirida) dhe
 - Linja 220 kV e dyfishtë ajrore Drenasi 2;
4. Shërbimet konsulente për Menaxhimin e implementimin Projektet e Zhvillimit të Transmisionit të Kosovë BERZH ;

Në vazhdim, është dhënë tabela e realizimit të buxhetit të projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2020:


1.	Shërbimet të Konsulencës për implementim e projekteve të financuara nga EBRD “Projektet e zhvillimit të Transmetimit të Kosovës “
Buxheti	1,300,000.00 €
Financues	BERZH / Kredi
Vlera e kontrates	1,343,487.25 €
Data e fillimit	Shtator2016
Data e perfundimit	Q2 2018 sipas vazhdimësisë 30.09.2019/2020
Kontraktues	AF Consult Switzerland Ltd
Buxheti i shpenzuar deri ne vitin 2020	1,139,250.45 €
Buxheti i shpenzuar gjate vitit 2020	99,435.68 €
Realizimi:	<p>i. Progresi</p> <p>Projekti i shërbimeve konsulente për mbikëqyrje të punëve të projekteve të EBRD, konform kontratës bazë dhe Amndment 1, 2 dhe 3 të kontratës ka vazhduar punëgjatë vitit 2020 në mbikëqyrje të:</p> <p><i>-LOT3: Linjat transmetuese ajrore dhe linjat kabllorike nëntokësore.</i></p> <p>Gjatë kuartalit të tretë (Q3) projekti i konsulencës ka përfunduar teknikisht dhe financiarisht.</p>

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 65 nga 124</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

	Diferenca e vlerave e paraqitur në mes të kontratës së nënshkruar dhe pagesave të realizuara, është si rezultat i pagesave pa TVSH, bazuar në ligjin për TVSH ngarkesa e kundërt.
2.	Projektet me EBRD LOT 1 – nënstacionet GIS No.45552
Buxheti	20,000,000.00€
Financues	BERZH (kredi)/KOSTT
Vlera e kontrates	Me TVSH 19,614,980.67 €
Data e fillimit	16.09.2016
Data e perfundimit	28.02.2020
Kontraktues	ABB (Italy & Croatia)
Buxheti i shpenzuar deri ne vitin 2020	16,958, 667.00 €
Buxheti i shpenzuar gjate vitit 2020	1,022,136.53€
Realizimi:	<p>(i) Progresi</p> <p>Viti 2020 në projekti LOT1 karakterizohet me realizimin e punëve rreth eliminimit te verezjtjeve nga ana e kontraktorit për Nënstacionet e reja: <i>NS Mitrovica 2,</i> <i>NS Drenasi të cilave iu ka skaduar afati garantues</i> <i>NS Prishtina 6 mbetet e pa përmbyllur financiarisht për shkak të mos mundësisë së përmbylljes së obligimeve për eliminimin e verezjtjeve nga ana e kontraktorit edhe për shkak të pandemisë.</i></p> <p>Gjatë vitit 2020 janë realizuar pagesa në vlerë 1,022,136.53 €, mbeten për realizim gjatë vitit 2021, 100,615.82 €</p> <p>Rreziku dhe pengesat Situata Pandemike për realizimin e udhëtimeve të ekspertëve.</p>
3.	Projektet me EBRD LOT 2 – transformatorët e fuqisë
Buxheti	4,000,000.00€
Financues	BERZH (kredi)/KOSTT
Vlera e kontrates	Me TVSH: 3,880,401.28€
Data e fillimit	16.09.2016
Data e perfundimit	15.09.2018
Kontraktues	Hyundai/Balkan Petrol

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	ver. 1.0	faqe 66 nga 124
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

Buxheti i shpenzuar deri ne vitin 2020	3,281,701.97 € (Pa TVSH)
Buxheti i shpenzuar gjate vitit 2020	6,032.00 €
Realizimi:	<p>(i) Progresi</p> <p>Projekti gjatë vitit 2020 ka qenë nën afatin garantues. Për shkak të mos përmbylljes dhe eliminimit të disa vërejtjeve si pasojë e pandemisë projekti nuk është përmbyllur edhe financiarisht për vlerën 6,032.00 €.</p> <p>(ii.) Rreziku dhe pengesat</p> <p>Situata Pandemike për realizimin e udhëtimeve të ekspertëve</p>
4.	Projektet me EBRD LOT 3 – Linjat transmetuese
Buxheti	7,663,246.33 €
Financues	EBRD/KOST T
Vlera e kontrates	Me TVSH 7,663,246.00€
Data e fillimit	03.10.2016
Data e perfundimit	30.04.2021
Kontraktues	Romelectro
Buxheti i shpenzuar deri ne vitin 2020	6,329,147.96 € (Pa TVSH)
Buxheti i shpenzuar gjate vitit 2020	379,081.52 €
Realizimi:	<p>(i) Progresi</p> <p>Viti 2020 kryesisht ka qenë përqendrimi në realizimin e punëve dhe përfundimin e atyre ndërtimore dhe ato instaluese në:</p> <p><u>Linja e re ajrore NS Therandë - NS Rahovec</u></p> <p>Ku punët kanë përfunduar dhe linja është energjizuar me 18.06.2020. Nga kjo kohë projekti është në fazën garantuese njëvjeçare</p> <p><u>Dhe janë zhvilluar punët në</u></p> <p><u>Linja Ajrore/Kabllore 110kV NS. FushëKosova</u></p> <p>Për shkak të problemeve me marrjen e pëlqimit nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe palëve të treta janë vonuar punët implementuese. Deri në fund të vitit 2020 janë përfunduar diku 62% e punëve.</p> <p>Gjatë vitit 2020 janë realizuar pagesa: 379,081.52€</p> <p>Mbeten obligime për vitin 2021 edhe 150,000.00€</p> <p>(ii) Rreziku dhe pengesat</p>

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 67 nga 124</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli


	Realizimi i projektit është vështirësuar edhe për shkak të situatës së COVID 19, dhe përshkak të problemeve pronesor-juridike me pronarët.
5.	Administrimi dhe mbikëqyrja e Marrëveshjes së Kyçjes me SOWI -LLC për Parkun Energjetik me Erë Selac 1, Selac 2 dhe Selac 3,
Buxheti	Asetet e vleresuara të Kyçjes 4,398,500€
Financues	Investitori SOWI
Vlera e kontrates	N/A
Data e fillimit	2018
Data e perfundimit	Q3 2021
Kontraktues	NOTUS
Buxheti i shpenzuar deri ne vitin 2020	N/A
Buxheti i shpenzuar gjate vitit 2020	N/A
Realizimi:	<p>(i) Progresi</p> <p>Gjatë vitit 2020 janë mbikëqyrë punët ndërtuese të Aseteve të kyçjes, konform Marrëveshjes së kyçjes. Projekti është realizuar rreth 80%.</p> <p>(ii) Rreziku dhe pengesat</p> <p>Ka probleme me pronarë, për zgjidhjen e të cilave përgjegjës është investitori.</p>

Tabelë. 7-1. Realizimi i buxhetit të projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2020

Në total gjatë vitit 2020, në implementim të projekteve për sigurinë e sistemit, rritjen e kapaciteteve transformues, për përkrahjen e ngarkesës janë investuar 1,5 milionë Euro, të cilat kryesisht janë nga kreditë nga Banka Evropiane për Zhvillim BERZH

Në vitin 2020 KOSTT ka angazhuar stafin e vet në Rilokimi i Linjës 110kV dhe kalim në linjë kabllore me kërkesën e aplikuesit privat për ndërtimin e –Qendrësindustriale “Prishtina Park”

Konform Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT ka angazhuar stafin në përcjelljen e punëve të ndërtimit të Aseteve të Kyçjes të Stacionit Gjenerues Energjetik me Erë (SGJEE) “Selaci 1” ku investitor është kompania SOWI KOSOVO L.L.C

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 68 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Viti 2020 rezulton me nënshkrim të Marrëveshjeve të Kycjes në Rrjetin e Transmisionit të paraqitura si më poshtë:

- AIR-ENERGY II sh.p.k. për Stacionin Gjenerues Energjetik me Erë (SGJEE) “Ka-menica 1” për kapacitet 34,8MW (21.12.2020); AIR-ENERGY IIsh.p.k. për Stacionin Gjenerues Energjetik me Erë (SGJEE) “Kamenica 2” për kapacitet 34,8MW (21.12.2020);
- Crescent Energy sh.p.k. për Stacionin Gjenerues Energjetik me DIELLE (SGJED) “Kamenica 3” për kapacitet 30MW (21.12.2020)
- Marrëveshja e kycjes me KEDS, për nënstacionet NS 220/10(20) kV Malisheva dhe NS 110/10(20) kV Kastrioti:

Konform ndryshimit të Metodologjisë së taksave të kycjes (versioni 3.0) dhe procedurave të kycjes janë shqyrtuar aplikacionet, janë përgatitë ofertat dhe draft Marrëveshjet e Kycjes si dhe zhvilluar diskutimi e komentimi i për :

- Marrëveshjen e Kycjes me Aplikuesin CICA VICA WIND FARM 1 sh.p.k. të Stacionit Gjenerues Energjetik me Erë “CICA VICA WIND FARM 1” me kapacitet 116,6 MW
- Marrëveshjen e Kycjes me Aplikuesin për Kycje në Rrjetin e Transmetimit “SOLAR ENERGY GROUP EUROPE “sh.p. k për Stacionin Gjenerues Energjetik me Diell “SEGE”150MWp (135MW);

Gjatë vitit 2020 janë përgatitur edhe Termat e References dhe Specifikimet teknike për projektet e mëposhtëme të cilat janë në procesin tenderues për projektet:

LOT 1: Ndërtimi I NS 110/10(20) kV Ferizaj 3;


LOT 2: Ndërtimi I Nënstacionit te ri - GIS 110/35/10(20) kV Fushë Kosovë;

LOT 3: Ndërtimi I Nënstacionet te Ri - AIS 220/35/10(20) kV Malisheva me linjën përcjellëse 220kV;

LOT 4: Furnizimi dhe instalimi I transformatorëve të fuqisë 40MVA në NS 110/35/10(20) kV Fushë Kosova dhe NS 220/35/10(20) kV Malishevë;

LOT 5: Ndërtimi i linjës/kabllos 110kV për kycje të nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Kastriot- Ferizaj 3; si dhe

Shërbimet konsulentë për projektin “Ndërrimi i Sistemit ekzistues SCADA\EMS në QND dhe QNDE”

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 69 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

7.2. Perspektiva për vitin e ardhshëm


Në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin, përpjekjet e KOSTT-it, edhe më tutje do të jenë të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike (të cekura në pikën 2.4. të këtij Raporti).

Përveç zhvillimeve që priten gjatë vitit 2021 në aspektin e operimit dhe tregut, bazuar në Planin e Biznesit 2021, KOSTT synon:

- Ofrimin e shërbimeve konsulentë për sektorin e energjisë elektrike, përfshirë edhe nivelin ndërkombëtar,
- Aprovimin e Politikës për Menaxhimin e Talenteve,
- Aprovimin e politikës për Barazi Gjinore
- Aprovimi Politikës për shqetësimet në vendin e punës

Zhvillimet kryesore nga aspekti i operimit të sistemit në KOSTT gjatë vitit 2021, do të jenë:

- Operimi i KOSTT si LFC Zonë në kuadër të LFC Bllokut AK, e krijuar nga KOSTT dhe OST e Shqipërisë;
- Nënshkrimin e marrëveshjeve të nevojshme si për RSC (Regional Security Coordination), EH (electronic highway), EAS (energy awareness system), VP (Verification Platform), OPC (outage planning coordination), SCC (Security critical coordination), TP (transparency platform), SMTA (short- & medium-term generation adequacy), CGM\OPDE (operational planning data environment), etj.
- Implementimi i Marrëveshjes për Rregullim Sekondar me OST;
- Implementimi i procedurës për shkëmbimin dhe aktivizimin e rezervave për balancim të zonave rregulluese dhe bllokut AK.
- Implementimi i Tregut Balancues sipas legjislacionit në fuqi;
- Operimi i tregut të liberalizuar në përputhje me ligjin e ri të energjisë elektrike;
- Pjesëmarrje në iniciativat dhe grupet punuese rajonale si EMI, SMTA, SCC, SOC dhe UCSI
- Investimi në platforma softuerike, që mundësojnë pjesëmarrje në operimin paralel interkonektiv në nivel pan evropian si RSCI (Regional Security Coordination), VP (Verification Platform), EH (electronic highway), TP (Transparency Platform), SMTA (short- & medium-term generation adequacy), CGM\OPDE (operational planning data environment), EAS (energy awareness system), OPC (outage planning coordination), SCC (Security critical coordination).
- Ringritja e infrastrukturës ekzistuese të sistemit SCADA/EMS që konsiston në:

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 70 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

- Ngritjen e nivelit të realizimit të kontrollit në objektet e rrjetit të transmetimit nga Qendra Nacionale Dispečerike Kryesore dhe Emergjente;
- Përmbyllja e krijimit të kushteve teknike për monitorim të ndërsjellë me AK LFC Bllokun,
- Përmbyllja e krijimit të kushteve teknike për monitorim të ndërsjellë me OST-të fqinje në kohën reale konform “Inter TSO Marrëveshjeve” me TSO-të e shteteve fqinje;
- Përgatitja e infrastrukturës teknike për qasje në platformën e EAS (Energy Awareness System) në kuadër të ENTSO-E.

Me fillimin e operimit të KOSTT si zonë e pavarur në kuadër të Bllokut Rregullues AK, pritet që KOSTT të fillojë menaxhimin komercial të kongjestioneve në edhe në kufirin me Serbinë dhe alokimin e kapaciteteve interkonektive.

Modi ri i operimit përfshin kryesisht aktivitetet që ndërlidhen me bashkëpunimin në kuadër të AK LFC Bllokut si dhe me OST-et e interkonektuara, me qëllim të operimit të sigurt të sistemit. Bashkëpunimi i ngushtë i OST-ve bazohet në parimet e respektimit të rregullave të ENTSO-E.

Grupi prej ekspertëve, i krijuar nga ENSTO-E (PG KOSTT), do të vazhdojë të bëjë monitorimin e KOSTT-it në plotësimin e kërkesave të vendosura nga ENTSO-E, për operim paralel të TSO-ve. Kërkesat janë kryesisht teknike, që ndërlidhen me sigurinë e operimit të sistemit, shkëmbimet tregtare ndërkufitare dhe plotësimi i kriterëve nga paketi i tretë i energjisë të KE.

Objektivat e monitorimit nga ENTSO-E janë:


- o Siguria e operimit të sistemit elektroenergjetik nga aspekti i rrjetit;
- o Siguria e Shërbimeve ndihmëse;
- o Ndryshimet e nevojshme rregullative që kërkohet nga paketi i tretë i legjislacionit të Komisionit Evropian për Energji

Duke i përcjellë zhvillimet e reja në sektorin e energjisë respektivisht, procesin e integriteteve evropiane, KOSTT duhet të ndjekë rrugën e plotësimit të kërkesave dhe standardeve që rrjedhin nga këto procese. Plotësimi i standardeve gjithashtu është kërkesë e procesit të zhvillimit të projekteve voluminoze në KOSTT.

Me zhvillimin e mëtejshëm të biznesit jo të rregulluar- komercializimin e shërbimeve nga lëmi i telekomunikimeve, KOSTT synon që të realizoj të hyra më të larta se në vitin 2020.

Për vitin 2021 pritet që KOSTT të nënshkruaj edhe marrëveshje tjera për shfrytëzimin e rrjetës së fibrave optik (dark fibre) duke synuar që të kalojë vlerën 300,000.00 euro. Me realizimin e këtij synimi KOSTT duhet të përmbush edhe disa kërkesa tjera të cilat janë të përcaktuara në Ligjin për Komunikimet Elektronike.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021, do të fillojnë punimet lidhur me projektin Ballkans Digital Highway, bazuar në asistencën teknike të aprovuar në aplikimin e paraqitur në WBIF (Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor. Zhvillimet e planifikuara në këtë projekt për vitin 2020 janë shtyrë për vitin 2021.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 71 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

7.2.1. Në kuadër të zhvillimeve kryesore nga aspekti i operimit të tregut, do të veçohen:

Liberalizimi i tregut dhe mundësitë e integritimit në tregun e përbashkët rajonal

Ndër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet sektori i energjisë elektrike në Kosovë është funksionimi i tregut efektiv konkurrues në sektorin e energjisë elektrike dhe integrimi në tregun e përbashkët rajonal.

Me udhëzimin e ZRrE-së për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë, është përcaktuar mënyra, kushtet dhe koha e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë, në nivelin e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike. Nga 1 prill 2017, tregtimi me shumicë i energjisë elektrike bëhet në çmime të de-rregulluara kurse de-rregullimi i çmimit të konsumatorëve fundorë do të bëhet në mënyrë graduale duke përdorur qasjen më të përshtatshme të mundshme me gjendjen aktuale.

Përkundër masave të ndërmarra drejt liberalizimit të tregut në Kosovë, deri tani mungon konkurrenca si në nivelin e tregut me shumicë po ashtu dhe atë me pakicë. Edhe pse ekzistojnë disa furnizues të licencuar për furnizim në tregun me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë, aktualisht vetëm KESCO bën furnizimin e të gjithë konsumatorëve të rregulluar dhe atyre të pa rregulluar ndërsa të tjerët ende nuk janë aktiv në treg.


Aktualisht në tregun e energjisë elektrike janë vetëm tre konsumatorë të parregulluar të cilët janë të kyçur në rrjetin e transmetimit (Ferronikeli i kyçur në nivelin 220kV, kurse Sharr-Cemi dhe Trepça në nivelin 110kV), ndërsa të gjithë konsumatorët tjerë furnizohen me çmime të rregulluara dhe janë pjesë e grupit të konsumatorëve me të drejtë të shërbimit universal. Sipas njoftimit të ZRrE edhe konsumatorët e kyçur në nivelin 35kV dhe 10kV të cilët plotësojnë kushtet sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, nga data 1 prill 2021 do të furnizohen me çmim të parregulluar dhe nuk do të jenë konsumatorë me të drejtë të shërbimit universal.

Duke pasur parasysh rrethanat e reja të krijuara KOSTT ka ndërmarrë dhe do të ndërmerr veprimet e nevojshme për realizimin e udhëzimeve të lëshuara nga ZRrE dhe obligimeve që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar:

- Janë rishikuar Rregullat e Tregut të cilat janë miratuar nga ZRrE në tetor 2018;
- Janë përpiluar procedurat e nevojshme për të mbështetur proceset në këtë drejtim.

Në përputhje me “Procedurën për tregtimin e energjisë elektrike” (të përpiluar nga KOSTT dhe miratuar nga ZRrE) që përcakton parimet e përgjithshme të blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike, Operatori i Tregut ka vazhduar të organizoi Ankandet ditore për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjet si dhe blerjen e energjisë balancuese duke zbutur devijimet e mëdha në sistem të shkaktuara pas rënies së njësisë gjeneruese. Gjithashtu gjatë këtij viti Operatori i Tregut ka bërë prokurimin e rezervave balancuese për Rezervën Manuale të Restaurimit të Frekuencës (mFRR) në mënyrë transparente, jo diskriminuese dhe të bazuar në treg.

7.2.2. Menaxhimi i procesit të Ndërrimit të Furnizuesit

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 72 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike të miratuar në vitin 2016, të drejtën e ndërrimit të Furnizuesit e ka çdo konsumator fundor, familjar ose jo familjar, ndërsa përgjegjësia për menaxhimin e procesit të ndërrimit të Furnizuesit i është dhënë Operatorit të Tregut. Këtë përgjegjësi Operatori i Tregut e ushtron sipas Rregullave të Tregut dhe Rregullës për Ndërrimin e Furnizuesit të miratuar nga ZRRE.

Në Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë të ZRRE-së, përcaktohen kriteret dhe afatet kohore të de-rregullimit të çmimit për furnizimin e konsumatorëve fundorë, ku në mes tjerash parashihet edhe de-rregullimi i çmimit duke u bazuar në nivelin e tensionit në të cilin janë të kyçur konsumatorët. Kështu që bazuar në njoftimin nga ZRRE nga data 1 prill 2021 të gjithë konsumatorët e kyçur në nivelin 35kV dhe 10kV të cilët plotësojnë kushtet sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, nga data 1 prill 2021 do të furnizohen me energji elektrike me çmime të parregulluar.

Bazuar në këtë KOSTT ka ndërmarrë dhe do të ndërmerr veprimet e nevojshme për menaxhimin e procesit të ndërrimit të Furnizuesit, në përputhje me Rregullat e Tregut dhe në afatet kohore të përcaktuara në udhëzuesin e ZRRE-së. Megjithatë duke pasur parasysh afatin kohor brenda të cilit duhet të përfundohet procesi i transferimit të konsumatorit dhe numrin e konsumatorëve që kanë të drejtën e ndërrimit të furnizuesit e që në të ardhmen ky numër pritet të rritet, atëherë KOSTT është duke planifikuar sigurimin e një softueri që ky proces të kryhet në mënyrë automatike dhe të jetë i auditueshëm.

Integrimi rajonal

Si rezultat i angazhimeve të vazhdueshme, KOSTT ka arritur të shënojë përparime drejt integritimit në mekanizmat rajonale dhe është:

1. Vëzhgues në RG SEE
 - a. Vëzhgues në SG CMMI
2. Themelues dhe aksionar i SEE CAO


KOSTT më 21 dhjetor 2015 ka nënshkruar Marrëveshjen për ITC (Marrëveshja për kompensimin e ndërsjellë të transimit të energjisë elektrike nëpër TSO-të e Evropës). Marrëveshja ka filluar të implementohet nga 1 Janari 2016.

Integritet në tregjet rajonale janë obligim që kërkohet të përmbushet nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe njëra ndër objektivat kryesore të përcaktuara në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës. Gjithashtu integrimi rajonal është ndër objektivat e rëndësishme të KOSTT-it që përkundër angazhimeve të vazhdueshme në këtë drejtim, edhe më tutje vazhdon të ballafaqohet me shumë pengesa drejt integritimit në mekanizmat rajonale.

7.3. Sfidat e KOSTT


Sfidat për KOSTT, përveç atyre të cilat dalin nga Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës janë adresuar për arritjen e objektivit të integritimit në tregun rajonal të energjisë, e që lidhen me:

- Operimin e KOSTT-it si zonë rregulluese në bllokun AK

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 73 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

- Adoptimet e kërkesave dhe standardeve ne përputhje me kodet e rrjetit dhe të marrëveshjes SAFA ;
- Integrimi i BRE-ve dhe balansimi i sistemit elektroenergjetik;
- Krijimin e bursës së energjisë në bashkëveprim me Shqipërinë;
- Integrimi në tregun rajonal të energjisë
- Performimi i operimit të sistemit konform Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E (kërkesat e vendosura në Katalogun e Masave të Projekt Group);
- Balancimi i Sistemit në kohë reale duke pasur parasysh pamjaftueshmërinë e produkteve balancuese të nevojshme;
- Përballimi i imbalanceve në kohë reale të shkaktuara nga BRE, veçmas pas fillimit të operimit të PE Selaci;
- Ndikimet hidrologjike dhe teknike në KESH në pamundësinë e aktivizimit të mFRR (rregullimit terciar) në kohëzgjatje më të madhe;
- Sigurimi i sasisë së nevojshme të aFRR (rregullimi sekondar), ndërsa po rritet kërkesa shkak i BRE-ve, duke pasur për bazë faktin se brenda Kosovës nuk ka mundësi;
- Mos adresimi i qëndrueshëm i furnizuesit me energji elektrike të pjesës veriore të Kosovës;
- Krijimi i kushteve për mundësimin e tregtimit ndërkuftar KOSTT-EMS;
- Nevoja për përshtatjen e Mekanizmit Balancues në kontekst të sjelljes korrekte të palëve tregtare ndaj programeve të deklaruara;
- Përballimi i fyteve të ngushta në rrjetin e transmetimit, veqenarisht në transformim, nëse vazhdon trendi aktual i rritjes së konsumit;
- Ndikimi i mundshëm në furnizim të pandërprerë gjatë fazave të kalimit në nivelin 20kV për shkak të kërkesave të KEDS-it;
- Domosdoshmëria e rritjes së stafit punues në Departamentin e Operimit të Sistemit shkak i rritjes së kërkesave dhe detyrave pas fillimit të operimit të KOSTT si LFC Zonë e pavarur në kuadër të AK LFC Bllokut;
- Për stafin e operimit të sistemit mundësimi i trajnimeve dhe pjesëmarrjes në grupet punuese të ENTSO-E, me qëllim të aftësimin për kryerjen e funksioneve nën rrethanat e operimit të KOSTT si LFC Zonë e pavarur;
- Ndikimi në operim efikas të sistemit i funksionimit adekuat të infrastrukturës për monitorim dhe kontroll (SCADA/EMS), telekom, TI dhe e tregut;
- Integrimi në FTP platformat në kuadër të ENTSO-E (EHV, EAS, OPC, RSC, TP,...), të cilat janë pjesë e kërkesave të listuara në Katalogun Masave të ENTSO-E.

KOSTT si operator i tregut do të vazhdojë aktivitetet që lidhen me liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe integrimin në mekanizmat rajonal. Në këtë drejtim aktivitetet e zhvilluara janë në përputhje me objektivat dhe kërkesat e qeverisë rreth liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës, kërkesat që dalin nga legjislacioni primar i sektorit të energjisë, kërkesat që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe MSA-së ndaj hapjes së tregut të energjisë, si dhe në pajtim me Direktivat e Komisionit Evropian.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 74 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

KOSTT ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për realizimin e udhëzimeve të lëshuara nga ZRrE, megjithatë mbetet sfida konkurrenca në tregun me pakicë dhe implementimi i Mekanizmit Balancues në përputhje të plotë me Rregullat e Tregut. Implementimi i marrëveshjeve për blerje të energjisë me BRE-të të cilat janë në operim ka filluar mirëpo rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të tyre paraqet sfida në vete në aspektin e parashikimit dhe menaxhimit të fondit për BRE. Kështu që gjate vitit 2021 pritet të filloj operimin komercial prodhuesi më i madh i BRE në vend me kapacitet 105 MW Parku energjetik me erë Selaci, si dhe shtatë hidrocentrale të kyçura në rrjetin e shpërndarjes me kapacitet total 25.4 MW. Rritja e kapaciteteve të BRE ka ndikim edhe në procesin e parashikimit adekuat të prodhimit sepse Operatori i Tregut është blerës i vetëm dhe i mbulon 75% të imbalancevet të BRE dhe këto imblance kanë ndikim në koston e fondit të BRE që mbulohet nga konsumatorët.

Në aspektin e integritimeve rajonale, më 1 prill 2016 ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, sipas së cilës, Kosova obligohet të përmbushë detyrimet që lidhen me integrimin në tregun e përbashkët rajonal (neni 114 i Marrëveshjes).

Me fillimin e operimit me 14 Dhjetor 2020 i Tregut të energjisë elektrike në Kosovë si zonë e pavarur tregtare, Operatori i Tregut do të operojë tregun e energjisë elektrike në përputhje me legjislacionin primar dhe sekondar si një zonë tregtare në vete.


Në aspektin e zhvillimit të tregut, do vazhdohet angazhimi rreth projektit për krijimin e një tregu të përbashkët Kosovë-Shqipëri. Krijimi i Tregut të përbashkët Kosovë- Shqipëri është një hap drejt integritimit në tregun pan-evropian në harmoni me objektivat e BE-së dhe Komunitetit të Energjisë si dhe iniciativës WB 6.

Duke pas parasysh karakteristikat e tregut në Kosovë dhe Shqipëri dhe objektivat e qeverive për furnizim të sigurt me energji elektrike, KOSTT dhe OST themeluan bashkërisht tregun e organizuar të energjisë elektrike një ditë para (Bursën e energjisë elektrike) që pritet të filloj operimin gjatë vitit 2021. KOSTT është aksionar në bursën shqiptare ALPEX. Procesi i bashkimit të dy tregjeve do të vazhdojë në harmoni me planet e përpiluara të nga të dy vendet. Por që të funksionojë bursa duhet të kemi një liberalizim të mëtejshëm të tregut të energjisë dhe kjo është një nga sfidat me të cilën do të përballemi në vitet në vijim.

7.4. Aktivitetet tjera

Sipas planit për investimet kapitale, në vitin 2021 është planifikuar përgatitja e specifikimit teknik, respektivisht finalizimi i specifikimit teknik të përgatitur nga stafi profesional i KOSTT, dhe fillimi i procedurave të prokurimit për projektin Ndërrimi i Sistemit Ekzistues SCADA /EMS në QND dhe QNDE, si dhe realizimi i projekteve tjera që janë në vazhdimësi. Poashtu, do të vazhdojë angazhimi për realizim të projekteve të cilat janë në planin investiv të aprovuar si dhe do te vazhdojë përkushtimi për të identifikuar veprimet e nevojshme për ngritjen e nivelit te sigurisë kibernetike.

Gjatë vitit 2020 pritet të realizohet renovimi i ndërtesave NS Podujeva, NS Gjakova 2, NS Prishtina 3, realizimi i punimit të rrethojave, si dhe realizimi kyçjeve në infrastrukturën e ujit/kanalizimit në disa

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 75 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

nënstacione. Gjithashtu, do të finalizohet projekti për ngritjen e nivelit të sigurisë në ndërtesën e selisë qendrore të KOSTT.

Në përputhje me një nga objektivat strategjike të KOSTT, që të përkujdeset për shëndetin e punëtorëve, pas implementimit të Ligjit për sigurimet shëndetësore mendohet që të shkohet edhe me projekte tjera për mbrojtjen e punëtorëve në aspektin e shëndetit duke u bazuar në sigurimet tjera si në rast të aksidenteve personale për pjesën e punëtorëve të cilët punojnë në kushte të veçanta të punës.

Me qëllim të azhurnimit dhe harmonizimit të plotë të kërkesave, KOSTT ka implementuar me përpikëri të gjitha kërkesat e standardit ISO 9001:2015.


Në kuadër të Menaxhimit të cilësisë KOSTT, ka zhvilluar dhe është certifikuar edhe dy standardet e reja: Standardi për sigurinë e mjedisit ISO 14001:2015 dhe standardi për Shëndet dhe siguri OHSAS 18001:2007.

Për qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm të SIM në harmoni me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e Standardeve KOSTT i ka bërë përgatitjet për kalimin nga OHSAS 18001 në Standardin ISO 45001:2018 i cili nga viti 2018 e zëvendëson OHSAS 18001. Kjo do të bëhet gjatë procesit të Ri-certifikimit në ISO Standarde.

Këto Standarde janë implementuar me përpikëri gjithmonë duke pasur përmirësim të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Njëkohësisht, KOSTT ka zhvilluar duke bërë integrimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe ndërtimin e një “sistemi të integruar të menaxhimit të cilësisë” duke krijuar mundësinë e plotësisht/integritit edhe të standardeve për siguri të informacionit 27001 si dhe Standardeve tjera të cilat në të ardhmen mund të implementohen.

KOSTT në vitin 2020 ka planifikuar fillimisht plotësimin e të gjitha kërkesave dhe për këtë qëllim ka shpallur Projektin për angazhimin e një konsulence e cila do të përgatitë kompaninë për certifikim me Standardin ISO 27001. Ky projekt është bartur për realizim në vitin 2021 dhe pastaj do të certifikohet me Standardin ISO 27001 për sigurinë e informacionit e cila do të realizohet krahas Certifikimit me Standardin ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2015 në kuadër të Sistemit të integruar të menaxhimit të cilësisë në KOSTT.

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 76 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	


8. Rreziqet

Në afarizmin e KOSTT, kanë ndikim edhe rreziqet e mundshme, si pasojë e ndikimeve që vijnë nga jashtë, respektivisht nga rrethina afariste, dhe si të tilla, kanë implikimet e tyre në veprimtarinë e KOSTT.

Në vazhdim janë analizuar dhe identifikuar disa nga këto rreziqe:

- Pamundësia e performimit efektiv të operimit të KOSTT-it si zonë/blok rregullues, përkatësisht implementimit të marrëveshjes së kyçjes KOSTT- ENTSO-E. Mundësia që për shkak të obstrukcioneve nga Serbia, të hyrat nga alokimi i kapaciteteve dhe kongjestionet në linjat interkonektive të mos realizohen për kufirin KOSTT-EMS. Si pasojë, kjo do të pengojë KOSTT dhe Kosovën në përmbushjen e zotimeve të 6 shteteve të Ballkanit, e njohur si iniciativa e WB6 për themelimin e tregut të organizuar (spot market), tregut rajonal balancues dhe alokimit rajonal të kapaciteteve interkonektive.
- Të hyrat nga alokimi i kapaciteteve përkatësisht menaxhimi i kongjestioneve sipas rregullave destinohet në zhvillimin e rrjetës interkonektive për zvogëlimin e kongjestioneve. KOSTT ka investuar në linjën 400kV Kosove-Shqipëri dhe ka filluar kthimin e kredisë. Kthimi i kredisë bëhet nga të hyrat 100% nga tarifa e konsumatorëve në Kosovë. Derisa nuk fillon operimi si zonë rregulluese, KOSTT nuk do të jetë në gjendje të realizojë mbledhjen e të hyrave nga alokimi i kapaciteteve
- Vështirësitë e mundshme financiare nga mos inkasimi i të hyrave;
- Vështirësitë e mundshme për balansim efikas të LFC Zonës së KOSTT, në rast të mos adresimit së furnizuesit për veriun e Kosovës;
- Risku rregullator në miratimin e tarifave që nuk reflektojnë koston reale;
- gjendja e aseteve të transferuara nga KEK-u gjithashtu paraqet kërcënim në zvogëlimin e performancës së furnizimit dhe kostot shtesë të zhvillimit
- pamundësia e operimit, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të një pjese të rrjetit transmetues të Kosovës, për shkak të qasjes së kufizuar në pjesën veriore të vendit, si dhe ndërhyrjes ilegale të Operatorëve serb EMS dhe EPS.
- Rreziqet nga sulmet kibernetike në infrastrukturën e KOSTT me theks të posaçëm në Operimin e Sistemit Transmetues dhe tregut të energjisë elektrike.

Në mënyrë që të ulet ndikimi në secilin rrezik, janë të domosdoshme këto veprime:

	RAPORT VJETOR 2020	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faje 77 nga 124</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli</i>	

- Vazhdimi i aktiviteteve rreth evitimit të pengesave nga EMS në implementimin e plotë të marrëveshjes së kyçjes KOSTT-ENTSO\E;
- Mundësimi i transaksioneve tregtare në kufirin KOSTT-EMS;
- Vazhdimi i aktiviteteve rreth adresimit të furnizuesit për veriun e Kosovës,
- Anëtarësimi sa më shpejt që është i mundur në ENTSO\E;
- Vazhdimi i aktiviteteve rreth evitimit të pengesave nga EMS dhe implementimi i marrëveshjes së kyçjes KOSTT-ENTSOE. Anëtarësimi sa më shpejt që është i mundur;
- Avancimi i operimit të sistemit të transmetimit që i paraprinë me aftësinë e sistemit elektroenergjetik të akomodojë kërkesat e shfrytëzuesve të sistemit, duke ofruar shërbime të kualitetit të lartë, posaçërisht ndaj investitorëve privatë të gjenerimit, furnizimit dhe shpërndarjes;
- Bashkëpunimi intensiv me palët e interesit duke sqaruar avantazhet e tregut të energjisë elektrike;
- Analiza e mundësisë që KOSTT dhe Kosova të jenë pjesë e APEX (Albanian Power Exchange), që është duke u zhvilluar në Shqipëri në kuadër të iniciativës WB6;
- Implementimi eficient i investimeve kapitale të KOSTT-it, duke përfshi edhe infrastrukturën për mbrojtjen nga sulmet kibernetike.

9. Aneks

9.1. Sponsorimet dhe donacionet

Gjatë vitit 2020, KOSTT ka ofruar përkrahje financiare në vlerën totale prej 5,000 €, për këto OJQ:

Down Syndrome Kosova	2,000.00
Renesansa	1,000.00
CSR NETWORK	1,000.00
AMC Akcioni për Nëna dhe fëmijë	1,000.00

10. Raporti i Auditorit të Brendshëm


